

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 1 prej 61
		Versioni	1.0

Plani investiv një (1) vjeçar i OSSh-së 2025

Mars, 2025

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 2 prej 61
		Versioni	1.0

PËRMBAJTJA

1.HYRJE	3
2.PROJEKTET NË TENSION TË MESEM	5
2.1 Projektet për shtimin e kapacitetit transformues dhe rivitalizimin e nënstacioneve 35/10(20) [kV]	5
2.2 Projektet e kalimit në nivelin e tensionit 20 [kV]	7
2.3 Projektet në nivelin 10 [kV]	23
2.4 Projektet në proces të implementimit	23
3.PROJEKTET NË TENSION TË ULËT.....	34
3.1 Projektet për zgjerim dhe përforcim të rrjetit 0.4 [kV]	34
3.1.1 Projektet e planifikuara për vitin 2025.....	35
3.1.2 Projektet e bartura në vitin 2025.....	37
3.1.2 Projektet TU 2025 – Veriu i Kosovës	39
4.PROJEKTET NË RRJET TË MENÇUR	40
5.PROJEKTET NË NJEHSORË	47
6.PROJEKTET NË LOGJISTIKË	48
7.PROJEKTET E TEKNOLOGJISE INFORMATIVE(IT).....	48
8.PËRFUNDIM	49
SHTOJCA 1:	50

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 3 prej 61
		Versioni	1.0

1.HYRJE

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes investon vazhdimisht në rrjetin e shpërndarjes bazuar në buxhetin e alokuar të investimeve të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Investimet e OSSh-së në rrjetin e shpërndarjes rrisin funksionimin e sistemit shpërndarës në mënyrë që të arrihet një furnizim i besueshëm me energji elektrike, të rritet kapaciteti i rrjetit ekzistues dhe përdorimi ekonomik i rrjetit të shpërndarjes. Rritja e shpejtë e kërkesës për energji po mbingarkon vazhdimisht linjat ekzistuese si rezultat i zhvillimeve të reja, duke shkuar kështu në kufi të kapacitetit maksimal të linjës. Prandaj, OSSh duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përmbushur detyrimin për të siguruar të gjithë përdoruesve të sistemit energji cilësore dhe mundësinë e kycjes në përputhje me ligjin e energjisë elektrike dhe kodin e rrjetit të shpërndarjes. Për më tepër, nga investimet e reja OSSh optimizon dhe balancon ngarkesat e daljeve.

Prioritizimi i projekteve të investimeve në rrjet bëhet duke analizuar kriteret teknike si:

- Humbjet
- Ngarkesën e rrjetit
- Rëniet e tensionit
- Indekset e ndërprerjeve
- Kërkesën totale në terma të energjisë
- Rritjen e konsumit
- Numrin e konsumatorëve

Pothuajse të gjitha daljet shpërndarëse kryesisht kanë topologji të ngjashme. Rrjeti në zonat radiale përbëhet nga linja të gjata dhe me shumë degëzime, ndërsa rrjeti në zonat urbane përbëhet nga një strukturë unazore e papërcaktuar që ka vështirësi për operim. Metodologjia e re e planifikimit nuk mbështet topologjinë ekzistuese të daljeve, prandaj daljet shpërndarëse janë të organizuara drejt një topologjie të re, standarde dhe sa më të thjeshtë për operim.

Me topologjinë e re arrihen synimet e planifikimit drejt:

- Rrjetit të zgjerueshëm, standard dhe të thjeshtë
- Përmirësimit të cilësisë së furnizimit për të gjithë konsumatorët
- Strukturës së rrjetit të besueshëm në zonat urbane

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 4 prej 61
		Versioni	1.0

- Reduktimit të humbjeve të energjisë
- Aftësisë së izolimit të defektit në rrjetin rural duke përdorur nënstacionet shpërndarëse në kryqëzimet e daljeve.

Njehsorët - përfshijnë projektet që janë si rezultat i kërkesave ligjore, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të shpërndarjes dhe të cilat do të ketë ndikim në të gjithë konsumatorët.

Projektet e rrjetit të mençur - Fokusi i aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm në mbarë botën, si dhe te ne është automatizimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, duke përdorur avancimet dhe zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë dhe sistemit të komunikimit të të dhënave. Në kuadër të kësaj pjese hyjnë projektet SCADA, DMS, GIS etj.

Logjistika - janë domosdoshmëri që sigurojnë vazhdimësinë e biznesit, dhe të cilat me kalimin e kohës duhet të ndërrohen për shkak të kostos së tyre të lartë të mirëmbajtjes dhe / ose dëmeve të riparuar.

Shërbimet mbështetëse - të cilat përfaqësojnë shërbime, të tilla si IT (Teknologji Informative), e të cilat janë edhe të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e biznesit por njëherazi janë edhe projektet sipas kërkesave ligjore.

Projektet e rrjetit të shpërndarjes do të kategorizohen si më poshtë:

Tensioni i mesëm (projektet në nivelin 35 [kV], projektet në nivelin 10 [kV], projektet për kalimin në nivelin 20 [kV]), tensioni i ulët (projektet për përforsim dhe zgjerim të rrjetit), rrjeti i mençur, njehsorët, IT, dhe logjistika.

Kostoja e alokuar për këto projekte për vitin 2025 është dhënë në tabelën më poshtë.

Projektet	Kostoja [Euro]
Tensioni i Mesëm	7,232,202.60
Tensioni i Ulët	9,677,563.10
Rrjeti i Mençur	1,765,071.43
Njehsorët	2,111,961.24
IT	1,331,800.00
Logjistika	546,000.00
TOTAL	22,664,598.37

Tabela. 1 Kostoja e aprovuar e projekteve për vitin 2025.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 5 prej 61
		Versioni	1.0

OSSH-ja kërkon të shtoj projekte shitesë gjatë vitit të ardhshëm, ku edhe kërkohet aprovimi nga Zyra e Rregullatorit.

Kostoja e përditësuar duke përfshirë projektet shitesë është dhënë në tabelën në vijim.

Projektet	Kostoja [Euro]	Kostoja – Mitrovica e Veriut [Euro]
Tensioni i Mesëm	11,225,681.27	59,878.85
Tensioni i Ulët	9,677,563.10	392,600
Rrjeti i Mençur	1,891,071.43	
Njehsorët	2,111,961.24	1,722,130
IT	1,331,800.00	
Logjistika	546,000.00	
TOTAL	26,784,077.04	2,174,608.85
TOTAL (me Mitr. Veriut)		28,958,685.89

Tabela. 2 . Kostoja e përditësuar e projekteve për vitin 2025.

Projektet shitesë të cilat kërkohen të realizohen nga OSSH-ja janë arsyetuar në vijim të dokumentit, por gjithashtu janë paraqitur informata shitesë edhe në Shtojcat e bashkangjitura bashkë me këtë dokument.

2.PROJEKTET NË TENSION TË MESËM

Projektet investive në tension të mesëm ndahen në:

1. Projektet në nivelin 35 [kV],
2. Projektet e kalimit në nivelin 20 [kV] dhe
3. Projektet në nivelin 10 [kV]

2.1 Projektet për shtimin e kapacitetit transformues dhe rivitalizimin e nënstacioneve 35/10(20) [kV]

Projektet e planifikuara për vitin 2025

Rivitalizimi i nënstacioneve dhe instalimi i kthinave të reja në nënstacione paraqet një proces të domosdoshëm në mënyrë që të sigurohet së pari siguria e sistemit elektrik shpërndarës e më pas edhe furnizimi me energji elektrike për konsumatorët. Për këtë arsye, nënstacionet ku planifikohen të instalohen kthina me qëllim të konvertimit të daljeve 10 [kV] në nivelin 20 [kV] janë:

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 6 prej 61
		Versioni	1.0

- NS Prizreni 3 110/10 [kV]
- NS Ferizaji 1 (Bibaj) 110/35/10 [kV]

Kthinat e instaluar në NS Prizreni 3 110/10 [kV] do të shërbejnë për konvertimin e daljes Zhupa nga niveli 10 [kV] në atë 20 [kV]. Për të njëjtin qëllim të konvertimit nga niveli 10 në atë 20 [kV] do të shërbejnë edhe kthinat që do të instalohen në NS Ferizaji 1 (Bibaj) 110/35/10 [kV].

Numri i kthinave që do të instalohen sipas nivelit të tensionit është paraqitur më poshtë:

Projekti - Ndërrimi i kthinave	Nr. i kthinave	35 [kV]	24 [kV]
Prizreni 3 110/10 [kV]	3	0	3
Ferizaji 1 (Bibaj) 110/35/10 [kV]	6	0	6
Vushtria 1 110/35/20 kV	12	4	8

Tabela. 3 Instalimi i kthinave në nënstacione.

OSSH gjatë viteve të fundit ka vazhduar me ndërrimin e transformatorëve problematik të fuqisë dhe instalimin e transformatorëve tërësisht të rinjë. Mirëpo ekziston ende një numër i caktuar i transformatorëve të fuqisë të vendosur në nënstacionet elektrike në Kosovë që janë të vjetër dhe kanë tejkaluar jetëgjatësinë e paraparë për të operuar që është gjithashtu kohëzgjatja për të cilën transformatorët janë projektuar zakonisht për të funksionuar. Ndërrimi i këtyre transformatorëve do të bëhet duke u bazuar në disa faktorë të ndryshëm si jetëgjatësia e transformatorëve, rezultatet e dobëta të testimeve, mbingarkesa e transformatorëve dhe gjendja e transformatorëve.

Ndërrimi i transformatorëve të fuqisë gjatë vitit 2025 do të realizohet në nënstacionet e mëposhtme.

Distrikti	Nënstacioni	TR	Sn [MVA]
Prishtina	Palaj 110/35/10 [kV]	TR2	8
Prishtina	Parku i Biznesit 35/10 [kV]	TR1	8
Peja	Peja II 35/10 [kV]	TR2	8
Prizreni	Zhuri 35/10 [kV]	TR1	8
Peja	Gurakovci 35/10 [kV]	TR1	4
Peja	Kfori 35/10 [kV]	TR1	4
Ferizaji	Shtime 35/10 [kV]	TR3	4
Gjakova	Gjakova III 35/10 [kV]	TR2	4
Prizreni	Prizreni 3 110/10 [kV]	TR1	8

Tabela. 4 Ndërrimi i transformatorëve të fuqisë gjatë vitit 2025.

Pra gjithsej 8 transformatorë parashihen të ndërrohen, ndërsa 1 transformator planifikohet të instalohet.

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e transformatorëve sipas transformimit të tensionit dhe sipas fuqisë:

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 7 prej 61
		Versioni	1.0

Nr.	Niveli i tensionit	S [MVA]	Nr. Transformatorëve
1	35/10(20) [kV]	2.5	0
2		4	4
3		8	4
4	10/20 [kV]	8	1
Total			9

Tabela. 5 Nderrimi dhe instalimi i transformatoreve sipas fuqise dhe transformimit.

2.2 Projektet e kalimit në nivelin e tensionit 20 [kV]

Prej të gjitha metodave për zvogëlimin e humbjeve teknike, metoda e kalimit prej një niveli të tensionit në një nivel më të lartë është mënyra më e mirë për përmirësimin e kualitetit të tensionit, gjegjësisht i zvogëlon humbjet teknike jashtëzakonisht shumë dhe përmirëson tensionin deri në pikën e fundit të konsumatorit nëpër daljet 20 [kV]. Për të realizuar investimet 20 [kV] në daljet 10 [kV], OSSh do të përdorë tri burime furnizimi:

- Do të investojë në daljet 10 [kV] në transformatorët e OST-së që e kanë mundësinë e kalimit në 20 [kV] ose do të kërkohet nga OST të përshtaten transformatorët,
- Do të shfrytëzohen transformatorët 8 [MVA] për t'i adaptuar në 35/20 [kV] për t'i furnizuar daljet e zgjedhura,
- Do të përdorën transformatorë ngritës 10/20 [kV] për të furnizuar dalje të zgjedhura për investim.

Projektet e planifikuara dhe të aprovuara në vitet e kaluara, implementimi i të cilave do të vazhdoj në vitin 2025

Vitet e fundit OSSh-ja ka pasur sfida që kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në aftësinë për të përmbushur premtimet për implementimin e projekteve sipas planeve dinamike të parapara. Edhe pse planifikimi është bërë në mënyrë të kujdesshme, prapë se prapë një numër faktorësh ka kontribuar në kohëzgjatjen e implementimit të këtyre projekteve. Është e rëndësishme të shprehim në mënyrë transparente këto sfida për të siguruar kuptim të rrjedhshëm të vështirësive gjatë fazës së implementimit të projekteve. Përballë këtyre sfidave, OSSh mbetet e përkushtuar për të kapërcyer këto pengesa për të arritur rezultate sa më të suksesshme.

Sfidat në të cilat OSSh-ja ka hasur gjatë implementimit të projekteve:

- Sigurimi i lejeve nga Komuna dhe Ministria e Infrastrukturës

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 8 prej 61
		Versioni	1.0

- Mungesa e Fuqisë Punëtore
- Problemet me konsumatorë.

Projektet të cilat janë planifikuar dhe aprovuar në vitin 2023, por implementimi i të cilave do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2025 janë:

Konvertimet e daljeve në 20 [kV] që planifikohet të realizohen me anë të mes-transformatorëve janë:

- Daljet nga NS Skenderaj: Turiqevci, Llausha, Likovci, Qirezi

Konvertimi i daljeve me anë të përshtatjes së transformatorëve të 110/35/10(20) kV të OST-së për nivelin 20 [kV]

Kalimi i daljeve 10 [kV] të NS Prishtina 2, Prishtina 3, Prishtina 5, Prishtina 6 dhe Prishtina 7, në kuadër të projekteve të dhëna si më poshtë, faza I:

- PR 3 - PR 5 Dalja e re 1 që përfshin daljet: Nr.14 Arbëria; Nr.21 Arbëria 5; j21 Kodra e Trimave 21; j27 Kodra e Trimave 5; j19 Kodra e Trimave 8;
- PR 3 - PR 5 Dalja e re 2 që përfshin daljet: Nr.22 Remonti Kablllovik; Dalja Nr.20; j25 Xhamia e Llapit I; j22 Kodra e Trimave 4; j17 Kodra e Trimave 9;
- PR 3 - PR 5 Dalja e re 3 që përfshin daljet: Nr.22 Remonti Kablllovik; Dalja Nr.20; j25 Xhamia e Llapit I; j22 Kodra e Trimave 4; j17 Kodra e Trimave 9;
- PR 2 - PR 5 Dalja e re 1 që përfshin daljet: Nr.16 SH.M."28 Nëntori"; Nr.22 Remonti Kablllovik; Nr.5 Xhemajl Ibishi; j18 Kodra e Trimave 8; j11 Kodra e Trimave 11;
- PR 2 - PR 5 Dalja e re 2 që përfshin daljet: Nr.27 Normalja; Nr.19 Ilirida; Nr.28 Muzeu 1; Nr.16 SH.M."28 Nëntori"; j18 Kodra e Trimave 8; j12 Kodra e Trimave 7;
- PR 2 - PR 5 Dalja e re 3 që përfshin daljet: Nr.25 Karadaku-Vreshtat; j12 Kodra e Trimave 7;
- PR 2 - PR 3 Dalja e re 1 që përfshin daljet: Nr.19 Ilirida; Nr.28 Muzeu 1; Nr.15 Blloku I; Nr.26 Nexhmi Mustafa; Radio Kosova; Nr.28 Sigurimi; Nr.31 Mark Isaku; Nr.30 Tirana;
- PR 2 - PR 3 Dalja e re 2 që përfshin daljet: Nr.6 Ibrahim Banushi; Radio Kosova; Nr.30 Tirana; Nr.8 Stacioni i Policisë; Nr.16 Lulishtja; Nr.17 Qafa ;
- PR 2 - PR 3 Dalja e re 3 që përfshin daljet: Nr.22 Shaip Kamberi; Nr.24 Diletacioni; Nr.23 Hotel Iliria; Nr.6 Iliria; Hoteli Grand; Nr.8 Stacioni i Policisë; Q.SH.K.S.E."Pallati i Rinisë";
- PR 3 - Dalja e re 1 Arbëria që përfshin daljet: Nr.3 Komuna e Re; j23 Komuna e Re;
- PR 3 - Dalja e re 2 Arbëria që përfshin daljet: Nr.18 Arbëria 2; j23 Komuna e Re; Nr.3 Komuna e Re;

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 9 prej 61
		Versioni	1.0

- PR 6 - PR 3 Dalja e re 1 (Përparimi) që përfshin daljet: Përparimi; Nr.32 SH.K.SH; Nr. 13 Drini i Bardhë-Furra; Nr.26 Fabrika e Tjegullave; j23 Komuna e Re;
- PR 6 - PR 3 Dalja e re 2 (Qyteza Pejton) që përfshin daljet: Qytetza Pejton 2; Nr.32 SH.K.SH; Radio Kosova; Përparimi;
- PR 6 - PR 3 Dalja e re 5 (Fakulteti Filozofik) që përfshin daljet: Fakulteti Filozofik; Radio Kosova; Objekti C7; Nr.8 Stacioni i Policisë; Nr.32 SH.K.SH; Hoteli Grand;
- PR 6 - PR 1 Dalja e re 3 (Kroni i Bardhe) që përfshin daljet: Nr.35 Kroni i Bardhë; Nr.12 Lakrishte Dardania Su7; Blloku1 Dardania; Don Bosko;
- PR 6 - PR 1 Dalja e re 4 (Dardania) që përfshin daljet: Dardania Bll. IX; Kurrizi 1; Blloku1 Dardania; Kosovatransi-Kazerma; Tjertorja, Un.Kosovateks; Policia;
- PR 5 Dalja re 1 që përfshin daljet: j14 Qendra e Panairëve dhe Shkabaj;
- PR 5 Dalja e re 2 që përfshin daljen j5 Bardhosh;
- PR 5 Dalja e re 3 që përfshin daljet: j5 Bardhosh dhe j6 Rezervoaret;
- PR 5 Dalja e re 4 që përfshin daljen j9 Llukar;
- PR 5 Dalja e re 5 që përfshin daljen j20 Pompat e ujësjellësit;
- PR 5 Dega e Butovcit që përfshin 12 Kodra e Trimave 7;
- PR 7 Dalja e re 1 që përfshin daljet: Spitali; j15 Viva Fresh; j31 Ndriqimi publik; j13 Fab. e Kasetave; Mikro;
- PR 7 Dalja e re 3 që përfshin daljet: J13 Fab. e Kasetave; j30 Grand Store; Çagllavica 3;
- PR 7 Dalja e re 6 që përfshin daljet: Hajvali; J13 Fab. e Kasetave; j12 Hajvalia;
- PR 7 Dalja e re 7 që përfshin daljet: j31 Ndriqimi publik; j15 Viva Fresh; j26 "Liridoni C;

Konvertimi i daljeve me anë të përshtatjes së TR-ve 35/10(20) [kV] për nivelin 20 [kV]

- Skivjani, Cermjani, Beci, Ponosheci, Dobroshi, Piskota dhe Ereniku - NS 35/10(20) [kV] Gjakova I TR 3x8 [MVA] - Cermjani, Beci, Ereniku, Skivjani janë në proces të implementimit, ndërsa në daljet e tjera investimet kanë përfunduar dhe në vitin 2025 do të konvertohen në 20 [kV].
- Mirusha, Bellanica, Caralluka, Kijeva, Banja, Dragobili, Spitali dhe Malisheva - NS 35/10(20) [kV] Malisheva (deri në implementimin e NS 220/10(20) [kV] Malisheva; transformatorët 35/10(20) [kV] do të shfrytëzohen diku tjetër) – Daljet Bellanica, Mirusha dhe Kijeva janë në proces të implementimit dhe pothuajse kanë përfunduar, ndërsa në daljet e tjera investimet kanë përfunduar dhe në vitin 2025 do të konvertohen në 20 [kV].

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 10 prej 61
		Versioni	1.0

Projektet 2024-2025

Projektet e paraqitura më poshtë janë të aprovuara për vitet 2024 – 2025.

- 04/24-01 [20kV] Konvertimi i Qendrës së Ferizajt në 20 [kV]
- 04/24-02 [20kV] Kosovapetroli
- 03/24-06 [20kV] Mushtishti.

Për të realizuar konvertimin në 20[kV] të këtyre daljeve ne duhet të bëjmë ndërrimin e të gjitha linjave, transformatorëve dhe kthinave jo të gatshme për operim në 20kV. Duke pasur parasysh që në “Planin Pesëvjeçar Investiv të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023-2027” nuk kemi kosto të aprovuar për ndërrimin e transformatorëve për daljet që do të konvertohen në 20 [kV], dhe nga ZRrE ne na është kërkuar që transformatorët që duhet të ndërrohen për konvertimin e daljeve në 20 [kV] t’i kërkojmë me anë të planeve investive 1-vjeçare. Ne planifikojmë që gjatë vitit 2025 të bëjmë konvertimin e daljeve ‘Konvertimi i Qendrës së Ferizajt në 20 [kV]’, ‘Kosovapetroli’, ‘Mushtishti’ të cilat janë projekte të aprovuar për periudhën 2024-2025. Për të bërë konvertimin në 20 [kV] të këtyre daljeve ne duhet të bëjmë ndërrimin e transformatorëve sipas tabelës së mëposhtme:

Emri i Projektit	Transformatorët									
	50 [kVA]	StepUp 10/20 [kV] 8[MVA]	100 [kVA]	160 [kVA]	250 [kVA]	400 [kVA]	630 [kVA]	1000 [kVA]	1250 [kVA]	1600 [kVA]
04/24-01 - Konvertimi i Qendrës së Ferizajt në 20 [kV]			2	2	4	4	18	5		6
04/24-02 - Kosovapetroli			2	1	5	3	1	3		
03/24-06 - Mushtishti			1	5	13	2	1	1		

Tabela. 6 Transformatorët që duhet të ndërrohen.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 11 prej 61
		Versioni	1.0

Projektet e planifikuara për vitin 2025

Projektet e kalimit në nivelin 20 [kV] për vitin 2025 janë:

- 08/25-01 [20kV] Dejani (2025)
- 03/25-02 [20kV] Zhupa (2025)
- 03/25-03 [20kV] Hasi II (2025)
- 03/25-04 [20kV] Bresana (2025)
- 04/25-06 [20kV] Gadime (2025-2026)
- 04/25-10 [20kV] Sllovia (2025-2026)
- 05/25-08 [20kV] Onix & Vrella (2025-2026)
- 05/25-16 [20kV] – Rahovica (2025)

****Në kosto të këtyre projekteve është përfshirë dhe kostoja e transformatorëve që kërkohen për projektet e vitit 2025, më poshtë gjeni listën e transformatoreve të cilët na nevojiten për projektet e vitit 2025 për konvertim të daljeve që janë në këto projekte.**

Emri i Projektit	Transformatorët									
	50 [kVA]	StepUp 10/20 [kV] 8[MVA]	100 [kVA]	160 [kVA]	250 [kVA]	400 [kVA]	630 [kVA]	1000 [kVA]	1250 [kVA]	1600 [kVA]
Dejani	1		5	10	8	3				
Zhupa	4		1	5	3	6	5			
Hasi II	1		3	4	6					
Bresana	1			5	4	2	2			
Gadime	2		1	6	2	1				
Sllovia			7	3	9	6	1	1		
Rahovica			5	5	4	1	2			
Onix & Vrella	1		6	10	13	1	7			

Tabela. 7. Transformatorët që nevojiten për Projektet e planifikuara për vitin 2025.

Në pjesën vijuese të raportit gjenden më shumë detaje të gjendjes pas investimit të daljeve të përfshira në investime.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 12 prej 61
		Versioni	1.0

• **Projekti: Dejni, 08/25-01 [20kV]**

Në gjendje ekzistuese dalja Dejni është mjaft e gjatë dhe si pasojë ka rënie të tensionit të mëdha. Përveç rënieve të tensionit, dalja e Dejnit është ndër daljet me humbjet më të larta teknike dhe ngarkesë të madhe. Prandaj që të përmirësohet kualiteti i furnizimit me energji dhe parametrat teknik të kësaj dalje është e domosdoshme që dalja të konvertohet në 20 [kV]. Në këtë dalje do të investohet tërësisht për ta konvertuar nga niveli 10 [kV] në nivelin 20 [kV].




Figura 1. Topologjia e propozuar e daljes Denji.

Dalja TM		Kërkesa	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
		[MW]					
Para	Dejni	5.05	181.8	2,622.20	0.59	216	2,024
Pas	Dejni 10 [kV]	5.00	105.8	2,555.43	0.68	-	1,881
	Dejni 20 [kV]	5.00	57.2	793.16	0.93	-	1,881

Tabela. 8 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

* Numri i konsumatorëve zvogëlohet për arsye se një transformatorë transferohet nga dalja Dejni në daljen Pataqani

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 13 prej 61
		Versioni	1.0

Për tu realizur ky konvertim, TR 2 do të operoj në 35/20 [kV], kurse TR 1 do të operoj në 35/10 [kV], si në figurën e mëposhtme.




Figura 2. Skema njëpölshe e propozuar për NS Xërxa.

- Projekti: Zhupa, 03/25-02 [20kV]**

Zhupa është një dalje rurale e gjatë me degëzime të shumta, që karakterizohet nga një numër i madh ndërprerjesh, kohëzgjatje mesatare e lartë e ndërprerjeve, rënie të tensionit, humbje të larta teknike dhe Pmax të madh. Dega kryesore e linjës nuk kërkon investim, por disa degë të linjës janë të ndërtuara me shtylla druri, përçues Al/Fe 25 [mm²] dhe kalon nëpër një terren malor të papërshtatshëm që ndikon në kohën e gjetjes dhe shmangies së ndërprerjeve dhe e vështirëson mirëmbajtjen. Në mënyrë që të zvogëlohen humbjet teknike, mbingarkesa e daljes dhe rëniet e tensionit së bashku me rehabilitimin e topologjisë është propozuar që dalja të konvertohet në 20 [kV] për të arritur rezultatet e dëshiruara.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 14 prej 61
		Versioni	1.0




Figura 3. Topologjia e propozuar e daljes – Zhupa.

Dalja TM		Kërkesa	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet	Tensioni	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
		[MW]		[MWh]	Min. [p.u]		
Para	Zhupa	5.93	112.04	3,860.61	0.65	146	4,291
Pas	Zhupa 10 [kV]	5.93	106.1	3,681.39	0.68	-	4,291
	Zhupa 20 [kV]	5.93	51.6	1,045.41	0.93	-	4,291

Tabela. 9. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

Për të konvertuar daljen Zhupa në 20 [kV] duhet të instalohej transformatori ngritës 10/20 [kV], me fuqi 8 [MVA], ndërsa në NS 110/35/10 [kV] Prizreni 3 do të vendosen 3 kthina 24 [kV].

- Projekti: Hasi II, 03/25-03 [20kV]**

Në gjendje ekzistuese dalja Hasi II është mjaft e gjatë, ka shumë humbje, ndërprerje dhe rënie të tensionit të mëdha. Me konvertimin e daljes në nivelin e tensionit 20 [kV] do të zvogëlohen humbjet, kohëzgjatja e ndërprerjeve dhe rritja e kapacitetit të rrjetit ekzistues, në mënyrë që të furnizohet të gjithë konsumatorët me energji cilësore dhe të besueshme.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 15 prej 61
		Versioni	1.0



Figura 4. Topologjia e propozuar e daljes - Hasi II.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Hasi II	4.23	119.11	1,262.80	0.74	193	2,038
Pas	Hasi II 10 [kV]	4.23	111.80	1,031.19	0.78	-	2,038
	Hasi II 20 [kV]	4.23	56.46	370.48	0.95	-	2,038

Tabela. 10. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

Dalja Hasi II dhe Dalja e re Hasi I që është projekt i vitit 2026 do të furnizohen nga NS Pirana në nivelin 20 [kV]. Për tu realizuar kjo, TR 2 8 [MVA] do të operoj në nivelin 20 [kV]. Prandaj këto dy dalje do të konvertohen në nivelin 20 [kV] në vitin 2026.




Figura 5. Skema njëpolëshe e propozuar për NS Pirana.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 16 prej 61
		Versioni	1.0

Projekti: Bresana, 03/25-04 [20kV]

Bresana karakterizohet me ngarkesë të madhe, humbje të larta teknike dhe rënie të tensionit. Dega kryesore e daljes nuk kërkon investim për arsye se është shtylla metalike dhe përçues Al/Çe 70 [mm²]. Investimet do të realizohen në degët dytësore të daljes që janë me shtylla druri dhe seksion jo të duhur. Për të arritur rezultatet e dëshiruara, planifikohet që dalja të konvertohet në nivelin 20 [kV] si zgjidhja e vetme për të përmirësuar performancën teknike të Bresanës.




Figura 6. Topologjia e propozuar e daljes – Bresana.

Dalja TM		Kërkesa	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
		[MW]					
Para	Bresana	4.15	132.77	1,112.20	0.77	72	2,169
Pas	Bresana 10 [kV]	4.15	91.80	1,034.25	0.78	-	2,169
	Bresana 20 [kV]	4.15	45.00	339.32	0.96	-	2,169

Tabela. 11 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

- Projekti: Sllovia, 04/25-10 [20kV]

Dalja 10 [kV] Sllovia furnizohet nga NS 110/35/10(20) [kV] Lipjani. Karakterizohet nga një numër relativisht i madh i prishjeve, rënie të lartë të tensionit tek konsumatorët fundorë, humbje të larta teknike, numër të madh të TS-ve, ngarkesë të madhe dhe linja të mbingarkuara për shkak të seksionit të vogël të përçuesve. Një pjesë e trungut të linjës është e ndërtuar me shtylla të drurit dhe me përçues me seksion Al/Fe 35 [mm²], ndërsa pjesa tjetër e linjës është e ndërtuar kryesisht me shtylla te betonit dhe me përçues

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 17 prej 61
		Versioni	1.0

Al/Fe 25 [mm²]. Si rezultat i kësaj gjendje të rrjetit, dalja është e ngarkuar rreth 125 [%]. Në figurën e mëposhtme është paraqitur topologjia e propozuar në Google Earth e daljes 20 [kV] Sllovia dhe legjenda me ngjyra e përdorur për llojin dhe seksionin e përcësve dhe kablllove që janë planifikuar të investohen. Është planifikuar që në pjesët e rrjetit ku shtyllat janë të betonit dhe në gjendje të mirë teknike, të zëvendësohen përcësit ekzistues me seksion të vogël me përcës me seksion të përshtatshëm për ngarkesat e pjesëve të caktuara të rrjetit.




Figura 7. Topologjia e propozuar e daljes 20 [kV] Sllovia.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Sllovia	3.96	124.58	1,829.19	0.83	88	2,475
Pas	Sllovia 10 [kV]	4.04	80.78	663.13	0.91	-	2,477
	Sllovia 20 [kV]	4.04	41.11	279.56	0.98		2,447

Tabela. 12 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 18 prej 61
		Versioni	1.0

- **Projekti: Gadime, 04/25-06 [20kV]**

Në gjendje ekzistuese dalja Gadime është mjaft e gjatë, ka shumë humbje dhe rënie të tensionit të mëdha. Sipas topologjisë së re të planifikuar do të përmirësohet kualiteti i furnizimit me energji për të gjithë konsumatorët dhe do të zvogëlohen humbjet e energjisë.




Figura 8. Topologjia e propozuar për daljen Gadime.

Dalja TM		Kërkesa	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet	Tensioni	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
		[MW]		[MWh]	Min. [p.u]		
Para	Gadime	4.44	176.88	2,658.44	0.56	105	2,097
Pas	Gadime 10 [kV]	4.48	98.41	2,154.80	0.73		2,099
	Gadime 20 [kV]	4.48	49.83	676.58	0.94		2,099

Tabela. 13 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

- **Projekti: Onix & Vrella, 05/25-08 [20kV]**

Onix & Vrella janë daljet e përzgjedhura për investim për shkak të problemeve me rënie të tensionit, humbjeve dhe mbingarkesës. Daljet janë kombinuar dhe është krijuar edhe një dalje e re në mënyrë që shpërndarja e ngarkesës të jetë e njëtrajtshme dhe duke krijuar kështu edhe një topologji më të përshtatshme për operim. Dalja ekzistuese Vrella e cila do të operoj në nivelin 10 [kV] do të furnizoj kryesisht bizneset. Seksioni i linjës është i mjaftueshëm që të sigurohet furnizim i sigurtë e kualitativ me energji. Kurse dalja e re Vrella dhe dalja Onix do të operojnë në nivelin 20 [kV] në mënyrë që përmirësohen rëniet e tensionit dhe të zvogëlohen humbjet teknike.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 19 prej 61
		Versioni	1.0




Figura 9. Topologjia e propozuar për daljen Vrella 20 [kV]




Figura 10. Topologjia e propozuar për daljen Onix 20 [kV]

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 20 prej 61
		Versioni	1.0




Figura 11. Gjendja propozuese për daljen Vrella 10 [kV].

Dalja TM		Kërkesa	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet	Tensioni	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
		[MW]		[MWh]	Min. [p.u]		
Para	Onix	4.05	113.7	2043.9	0.83	88	2,049
	Vrella	4.88	151.1	1743.21	0.77	91	2,381
Pas	Onix 10 [kV]	4.22	87.3	1350.48	0.86	-	2,060
	Onix 20 [kV]	4.22	42.5	543.06	0.98		2,060
	Vrella 20 [kV] - Dalja e re	4.49	40.7	408.38	0.987	-	2,638
	Vrella 10 [kV] - Dalja e re	4.49	80.1	731.98	0.938	-	2,638
	Vrella 10 [kV] - Dalja ekzistuese	1.17	31.7	152.18	0.985	-	228

Tabela. 14 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Dobrusha	2.93	101.10	695.77	0.859	102	1,524
Pas	*Dobrusha	1.98	68.20	426.30	0.887		1,028

Tabela. 15 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

** Pasi të transferohen 12 trafostacione nga dalja Dobrusha te dalja Onix*

Për të konvertuar daljen Vrella në 20 [kV] duhet të instalohet transformatori ngritës 10/20 [kV], me fuqi 8 [MVA], ndërsa në NS Istogu 110/10 [kV] do të vendosen 3 kthina 24 [kV], në vitin 2026.

Dalja Onixi është planifikuar të operoj në nivelin 20 [kV]. Për t'u arritur kjo do të shtohet kapaciteti transformues në NS nga 4+8 [MVA] në 8+8 [MVA] në vitin 2026, ku një TR do të furnizoj daljen e Onix-it kurse TR tjetër pjesën e mbetur të daljeve.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 21 prej 61
		Versioni	1.0




Figura 12. Skema njëpolëshe e propozuar për NS Gurakoci.

- **Projekti: J14 Rahovica, 04/28-01 [20kV]**

Dalja 10 [kV] Rahovica furnizohet nga nënstacioni NS 110/35/10 [kV] Bibaj. Në gjendje ekzistuese dalja Rahovica është mjaft e gjatë dhe e mbingarkuar dhe si pasojë humbjet teknike dhe rëniet e tensionit janë shumë të larta. Poashtu kjo dalje karakterizohet edhe me numër të madh të ndërprerjeve. Në vitin 2019 është investuar në pjesën më të madhe të daljes mirëpo që të përmirësohet kualiteti i furnizimit me energji dhe të përmirësohen parametrat teknik të kësaj dalje është e domosdoshme që dalja të konvertohet në 20 [kV]. Gjithashtu, duhet të investohet në disa degëzime, pasi rrjeti ekzistues ndodhet në një terren me qasje të vështirë. Në gjendjen e propozuar, është planifikuar që linjat e reja të implementohen përgjatë rrugës. Kjo siguron qasje më të lehtë në rast të prishjeve eventuale dhe për mirëmbajtje.




Figura 13. Topologjia e propozuar e daljes - Rahovica.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 22 prej 61
		Versioni	1.0

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Rahovica	5.66	109.51	1,511.84	0.838	88	2,440
Pas	Rahovica	5.66	53.89	398.03	0.959	-	2,440

Tabela. 16 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

Shënim: Daljet 10 [kV] Zhupa, Dejani dhe Gadime janë dalje që kanë humbje teknike të mëdha dhe rënie të larta të tensionit. Kjo ka ndodhur për faktin që këto dalje kanë degëzime të shumta, numër të madh të TS-ve distributive, ngarkesë maksimale të lartë dhe distancë të madhe nga burimi deri te konsumatorët fundorë.

Pas planifikimit të investimit në këto dalje, dhe pas simulimit në aplikacionin PowerFactory DigSilent në nivelin 10 [kV], humbjet kanë vazhduar të mbeten të larta, linjat e mbingarkuara dhe rëniet e tensionit kanë mbetur pothuajse të njëjta me ato para investimit. Prandaj, për të ulur humbjet teknike dhe për të përmirësuar kualitetin e tensionit, konvertimi i këtyre daljeve në nivelin 20 [kV] do të jetë i domosdoshëm.

Megjithatë, edhe pas konvertimit të daljeve në 20 [kV], rëniet e tensionit mbesin të theksuara (0.93 p.u.). Në të ardhmen, kjo mund të jetë sfidë për Rrjetin Shpërndarës nëse do të ketë rritje të ngarkesës së daljeve si rezultat i kërkesave për kyçje të reja të konsumatorëve, sepse kjo do të ndikojë që rëniet e tensionit të jenë jashtë standardeve të kërkuara.

Në raste të tilla, KEDS në të ardhmen duhet të gjejë zgjidhje të përshtatshme për të siguruar kapacitete të domosdoshme duke ju mundësuar konsumatorëve të rinj kyçje pa pengesë në Rrjetin Shpërndarës dhe furnizim kualitativ me energji elektrike. Kjo mund të bëhet duke ndarë ngarkesën e daljeve, qoftë duke krijuar dalje të reja që do të furnizohen nga i njëjti burim ose burime të tjera, qoftë duke optimizuar shpërndarjen e ngarkesës përmes riorganizimit të rrjetit ose në rastet kur ka mundësi të kyçen burime të ripërtëritshme të energjisë elektrike.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 23 prej 61
		Versioni	1.0

2.3 Projektet në nivelin 10 [kV]

Projektet e planifikuara për investim në nivelin 10 [kV] janë dizajnuar për të mundësuar furnizim të sigurt dhe të pandërprerë me energji për konsumatorët, për të siguruar funksionimin e rrjetit në përputhje me rregullat, kodet dhe ligjet në fuqi. Objektivat kryesore të këtyre projekteve i adresohen çështjeve sipas prioriteteve të mëposhtme:

- Rritja e sigurisë, efikasitetit, besueshmërisë dhe cilësisë teknike të rrjetit të shpërndarjes
- Rritja e cilësisë së furnizimit me energji elektrike (treguesit e vazhdimësisë së furnizimit, cilësisë së tensionit, etj.)
- Përshtatja e kapaciteteve bartëse dhe transformuese në raport me rritjen e ngarkesës dhe konsumit të energjisë
- Zvogëlimi i humbjeve teknike
- Rehabilitimi dhe modernizimi i stabilimenteve dhe rrjetit ekzistues
- Pajtueshmëria me standardet e operimeve dhe performancës

2.4 Projektet në proces të implementimit

Projektet e planifikuara dhe të aprovuara në vitin 2024, implementimi i të cilave do të vazhdojë edhe në vitin 2025

Distrikti Pejë: "Spitali i Pejës, Maja e Zezë" dhe Ledinat;

Distrikti Gjakovë: "Xërxa, 18 Nëntori", "Xërxa, Ura Terezive, Opterushta", "Opterushta, Fortesa, Bodrumi";

Distrikti Mitrovicë: Maxhunaj dhe Nadakofc;

Distrikti Gjiilan: Begunca.

Distrikti Prizren: Hoqa e Qytetit

Projektet 2024-2025

Projektet e paraqitura më poshtë janë të aprovuara për vitet 2024 – 2025.

- 08/24-03 [10kV] Pataqani
- 01/24-05 [10kV] Dalja e re nga NS Podujeva (Letanci & Fshatrat 1)
- 01/24-04 [10kV] Dalja e re nga NS Besi (Lluzhani & Fshatrat 2)

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 24 prej 61
		Versioni	1.0

Projektet e planifikuara për vitin 2025

Projektet në nivelin 10 [kV] për vitin 2025 janë:

- 03/25-09 [10kV] - Rahoveci & Rruga e Nashecit (2025-2026)
- 07/25-12 [10kV] - Stacioni Hekurudhor & Novolani (2025-2026)
- 04/25-11 [10kV] – Kraishta (2025-2026)
- 04/25-13 [10kV] – Carraleva (2025)
- 07/25-14 [10kV] - Radavci & Dalja e re Radavci 1 (2025-2026)
- 04/25-17 [10kV] - Jezerci (Projekt shtesë - 2025)
- 05/25-15 [10kV] - Vitimirica (Pjesërisht - 2025)
- 07/25-18 [10kV] – Brgjani (2025)

- **Projekti: Rahoveci & Rruga e Nashecit, 03/25-09 [10kV]**

Rahoveci karakterizohet me një numër të madh të prishjeve, rënie të tensionit, humbje të larta teknike dhe Pmax të madh. Rrjeti shpërndarës i kësaj dalje furnizon kryesisht bizneset përgjatë rrugës Prizren-Gjakovë dhe një numër më të vogël të konsumatorëve në zonat urbane dhe rurale. Linja është e ndërtuar me shtylla druri dhe me përçues Al/Fe 35 [mm²] dhe Al/Fe 25 [mm²]. Për të përmirësuar parametrat teknik, do të investohet në tërë daljen, duke vendosur dhe Stabiliment Shpërndarës. Gjithashtu, në këtë investim përfshihet dhe dalja Rruga e Nashecit për të transferuar një pjesë të TS-ve, në mënyrë që të arrihet një balancim i ngarkesës ndërmjet daljeve.




Figura 14. Topologjia e propozuar e daljes 10 [kV] Rahoveci.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 25 prej 61
		Versioni	1.0




Figura 15. Topologjia e propozuar e daljes 10 [kV] Rruga e Nashecit.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Rahoveci	5.42	150.10	1,316.69	0.81	156	1,667
	Rruga e Nashecit	1.19	19.99	78.88	1.04	11	470
Pas	Rahoveci	2.75	37.60	140.29	1.02	-	562
	*Rruga e Nashecit	1.96	35.50	63.33	1.03	-	763

Tabela. 17 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	5 Dëshmorët	5.11	85.45	582.01	0.971	29	1,969
	Pirana	2.48	102.20	107.48	1.009	28	728
Pas	**5 Dëshmorët	5.35	89.29	608.83	0.966	-	2,050
	***Pirana	2.55	104.82	93.89	1.008	-	737

Tabela. 18. Të dhënat teknike, pas transferimit të TS-ve

* Pasi të transferohen 6 trafostacione nga dalja Rahoveci te dalja Rruga e Nashecit

** Pasi të transferohen 2 trafostacione nga dalja Rahoveci te dalja 5 Dëshmorët

*** Pasi të transferohen 2 trafostacione nga dalja Rahoveci te dalja Pirana

- Projekti: Stacioni Hekurudhor, Novolani & Dalja e re, 07/25-12 [10kV]**

Daljet 10 [kV] Stacioni Hekurudhor & Novolani furnizojnë konsumator në zonat rurale, karakterizohen me shumë degëzime, numër të madh të TS-ve, ngarkesë maksimale të madhe, humbje të larta teknike, rënie te

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 26 prej 61
		Versioni	1.0

tensionit nën standarde të kërkuara dhe numër të lartë të ndërprerjeve të pa planifikuara. Trungu i daljes Stacioni Hekurudhor është i ndërtuar me shtylla druri dhe me përçues Al/Çe 25 [mm²], ndërsa një pjesë e trungut të daljes Novolani është e ndërtuar me shtylla druri dhe me përçues Al/Çe 25 [mm²] dhe Al/Çe 35 [mm²]. Gjithashtu, pjesa më e madhe e degëzimeve të këtyre daljeve janë të ndërtuara me shtyllat drurit dhe me përçues Al/Çe 25 [mm²].

Me këtë investim do të zëvendësohen shtyllat e drurit me shtylla betoni dhe ndërrimi i përçuesve me kablllo ose përçues me seksion më të lartë sipas nevojës, ku ky investim do të ndikojnë në uljen e humbjeve, rënieve të tensionit dhe uljen e ngarkesës maksimale të linjës.




Figura 16.Topologjia e propozuar e daljes Stacioni Hekurudhor.




Figura 17.Topologjia e propozuar e daljes Novolani

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 27 prej 61
		Versioni	1.0

	Dalja TM	Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Novolani	3.46	119.01	1142.16	0.832	183	1,831
	Stacioni Hekurudhor	3.74	149.63	1043.91	0.868	157	1,812
Pas	Novolani	3.4	48.1	414.14	0.991		1,791
	Stacioni Hekurudhor	3.8	53.6	238.38	1.007		1,852

Tabela. 19 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

• Projekti: Radavci, 07/25-14 [10kV]

Me investimet e propozuara, dalja Radavci do të ndahet në dy dalje. Në pjesën vijuese të raportit gjendet përshkrimi për secilën dalje. Daljet do të operojnë në nivelin 10 [kV].

Dalja Radavci, 10 [kV]

Në figurën e mëposhtme është paraqitur topologjia e propozuar për Daljen e Radavcit në Google Earth dhe legjenda me ngjyra e përdorur për llojin dhe seksionin e përcësve që është planifikuar të investohen. Pjesa në fillim të linjës do të mbetet ekzistuese, do të investohet në degëzimet me përcës ajror.




Figura 18. Topologjia e gjendjes së propozuar për daljen Radavci.

Dalja e re Radavci 1, 10 [kV]

Në figurën e mëposhtme është paraqitur topologjia e propozuar për Daljen e Re Radavci në Google Earth dhe legjenda me ngjyra e përdorur për llojin dhe seksionin e përcësve dhe kablllove që është planifikuar të investohen. Në fillim të daljes nga NS 110/35/10 [kV] Peja 1 do të implementohet linjë nëntokësore me

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 28 prej 61
		Versioni	1.0

kabllo XHE 49A 240 [mm^2] deri tek Stabilimenti Shpërndarës Novosellë. Nga stabilimentit shpërndarës dalja do te ndahet ne tri degëzime si në figurën e mëposhtme.




Figura 19. Topologjia e propozuar për daljen e re Radavci.

Në tabelë janë paraqitur kalkulimet e gjendjes ekzistuese dhe gjendje së propozuar të daljeve Radavci dhe Dalja e re Radavci.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkë Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min.[p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Radavci	5.21	127.90	1,415.40	0.833	135	2,708
Pas	Radavci	1.55	31.70	113.36	0.99		708
	Dalja re Radavci	3.66	56.20	353.60	0.95		2,000

Tabela. 20 .Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

- Projekti: Carraleva, 04/25-13 [10kV]**

Dalja 10 [kV] Carraleva furnizohet nga NS 35/10 [kV] Shtime. Karakterizohet nga një numër i madh i prishjeve, rënie të lartë të tensionit tek konsumatorët fundorë, humbje të larta teknike, numër të madh të TS-ve, ngarkesë të madhe dhe linja të mbingarkuara për shkak të seksionit të vogël të përçuesve. Si rezultat

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 29 prej 61
		Versioni	1.0

i gjendjes ekzistuese të rrjetit, dalja është e ngarkuar rreth 157 [%]. Në daljen Carraleva do të investohet nga NS Shtime deri te Stabilimenti Shpërndarës.




Figura 20. Topologjia e propozuar e daljes 10 [kV] Carraleva.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Carraleva	4.49	156.76	1090.61	0.837	138	1,736
Pas	Carraleva	4.49	63.57	391.56	0.961		1,736

Tabela. 21 Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

- Projekti: Kraishta & Kraishta 1, 04/25-11 [10kV]**

Dalja 10 [kV] Kraishta furnizohet nga nënstacioni Lipjani 110/10 [kV]. Në gjendje ekzistuese dalja Kraishta është mjaft e gjatë dhe e mbingarkuar dhe si pasojë humbjet teknike dhe rëniet e tensionit janë shumë të larta. Në mënyrë që të shkarkohet dalja Kraishta, propozohet që të ndahet në dy dalje. Një pjesë e TS-ve (16 TS) do të transferohen nga dalja 10 [kV] Kraishta në daljen e re 10 [kV] të emëruar Kraishta 1, e cila poashtu do të furnizohet nga NS 110/35/10(20) [kV] Lipjani.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 31 prej 61
		Versioni	1.0

- Projekti: Vitimirica, 05/25-15 [10kV]**

Dalja 10 [kV] Vitimirica furnizon kryesisht konsumator në zonat rurale, është dalje relativisht e gjatë me shumë degëzime, Pmax të madh, ngarkesë maksimale të linjës mbi 160%, rënie të larta te tensionit, numër të madh te ndërprerjeve dhe humbje teknike të mëdha. Për të përmirësuar parametrat teknik, është planifikuar që në këtë fazë investimet të fokusohen në trungun e linjës. pjesërisht ndërsa në vitet e ardhshme do të ketë investime të mirëfillta.




Figura 23. Topologjia e propozuar e daljes Vitimirica.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Vitimirica	4.64	162.70	1,086.75	0.790	69	2,115
Pas	Vitimirica	4.64	72.25	606.27	0.880		2,115

Tabela. 23 Të dhënat para dhe pas investimeve.

Projektet shitesë

- Projekti: Jezerci, 04/25-17 [10kV]**

Dalja 10 [kV] Jezerci karakterizohet me numër të madh të prishjeve, rënie të larta te tensionit, humbje teknike të mëdha, Pmax të madh dhe mbingarkesë të linjave. Në fund të daljes, dy degëzime kalojnë në teren malor të papërshtatshëm që ndikon në kohën e gjetjes dhe evitimit të prishjeve si dhe e vështirëson mirëmbajtjen. Për të përmirësuar parametrat teknik, është planifikuar që në këtë fazë investimet të kryhen pjesërisht ndërsa në vitet e ardhshme do të ketë investime të mirëfillta.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 32 prej 61
		Versioni	1.0

Në figurën e mëposhtme është paraqitur topologjia e propozuar e Jezercit.




Figura 24. Gjendja e propozuar për investime në daljen 10 [kV] Jezerci

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kalkulimet teknike për daljen Jezerci.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Jezerci	4.69	133.64	1,079.55	0.803	219	2,179
Pas	Jezerci	3.95	81.73	784.45	0.876		1,852

Tabela. 24. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

- Projekti: Brgjani, 07/25-18 [10kV] – Veriu i Kosovës**

Dalja 10kV Brgjani furnizohet nga NS 35/10 [kV] Zveçani i Vogël. Kjo dalje furnizon kryesisht konsumator në zonën urbane dhe rurale, Pmax të madh dhe ngarkesë maksimale të linjës mbi 90 [%].

Për të shkarkuar dhe të arrihet një balancim i ngarkesës së daljes, propozohet që dalja 10 [kV] Brgjani të ndahet në dy dalje.

Do të investohet vetëm në daljen e re që është emërtuar Brgjani 2, duke zëvendësuar përcuesit e seksionit të linjës ajrore të një pjese të trungut të linjës dhe duke implementuar linjë të re në trungun e daljes 10[kV] Brgjani 2.

Në fig.25 dhe në fig.26 është dhënë topologji e propozuar e daljeve 10[kV] Brgjani dhe Brgjani 2.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 33 prej 61
		Versioni	1.0




Figura 25.Topologjia e propozuar e daljes Brgjani.



Figura 26.Topologjia e propozuar e daljes Brgjani 2.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Brgjani	4.11	91.75	-	0.953	-	-
Pas	Brgjani	1.48	40.48	-	0.995	-	-
	Brgjani 2	2.63	52.33	-	0.976	-	-

Tabela. 25. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 34 prej 61
		Versioni	1.0

3.PROJEKTET NË TENSION TË ULËT

3.1 Projektet për zgjerim dhe përforcim të rrjetit 0.4 [kV]

Në gjithë rrjetin e OSSH-së, ka pjesë të rrjetit të cilat kërkojnë investime për shkak të infrastrukturës së vjetër. Në mënyrë që të investohet në zonat më kritike, analiza është bërë duke marrë parasysh kriteret e prioritetëve për zgjedhjen e projekteve.

Qëllimet kryesore të projekteve për përforcim të rrjetit janë:

- Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe zvogëlimi i humbjeve teknike, dhe
- Qasje më e lehtë në pikën matëse dhe reduktim i humbjeve jo-teknike

Investimet e bëra në projektet e tensionit të ulët përfshijnë:

- Ndërtimi i transformatorëve distributiv të rinj 10(20)/0.4 [kV] në një regjion apo më shumë ku vlera e humbjeve teknike dhe jo-teknike në rrjetin e tensionit të ulët është shumë e madhe
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues 10 [kV] deri te transformatori i ri
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues ose ndërtimi i rrjetit të ri në TU
- Montimi i kutive (kuadrove) nëpër shtylla nëse është rrjet ajror dhe nëpër kuadro të tokës nëse është rrjet nëntokësor
- Vendosja, gjegjësisht bartja e njehsorëve prej shtëpive për t'u vendosur nëpër kuadrot e montuar në shtylla
- Ndërrimi i njehsorëve mekanik me ata 'të mençur', dhe
- Montimi i PLC-ve

Përfitimet e pritshme përfshijnë: furnizim të qëndrueshëm të energjisë, përmirësimin e kualitetit të tensionit, reduktimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike dhe përmirësimin e topologjisë së rrjetit. Projektet e vitit 2025 do të jenë në proces të implementimit edhe gjatë vitit 2026 dhe 2027. Kostoja e ndarë nëpër vite dhe e aprovuar në kuadër të Planit investiv pesëvjeçar 2023-2027 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	KOSTOJA		
	2025	2026	2027
Projektet e bartura	7,008,985.70		
Projektet - 2025	2,668,577.41	4,558,830.30	5,500,192.29
Total	9,677,563.11	4,558,830.30	5,500,192.29

Tabela. 26 Kostoja e aprovuar për TU në Planin Investiv 2023-2027.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 35 prej 61
		Versioni	1.0

3.1.1 Projektet e planifikuara për vitin 2025

Projektet që janë të planifikuara për vitin 2025 janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme e cila përmbanë të dhënat për projektet e planifikuara në vitin 2025, të ndara sipas distrikteve. Projektet e vitit 2025 do të jenë në proces të implementimit edhe gjatë vitit 2026 dhe 2027.

Distrikti	Subdistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Numri i konsumatorëve
DPR	Podujevë	14000002011	Shaban Shala	397
DPR	Prishtina - Veri	13000006085	Ismet Asllani	280
DPR	Prishtina - Jug	19000039147	Hajvalia vorret	333
DPR	Prishtina - Veri	12000015068	Jakov Xoxa 2	453
DPR	Obiliq	18024001038	Lajthishte	182
DPR	Fushë Kosovë	15018007085	Ashkalit II	220
DPZ	Prizreni - Qendër	31000026025	Lubinja e poshtme II	206
DPZ	Prizreni - Qendër	30000003005	Durmish Asllani IV	598
DPZ	Prizreni - Qendër	30033004013	Tusus III	739
DPZ	Prizreni - Qendër	30034003011	Romaja I	204
DPZ	Prizreni - Qendër	31000026012	Llokvice	174
DPZ	Prizreni - Qendër	31000026002	Pllanjan I	229
DPZ	Dragash	30036007024	Zaplugje I	108
DPZ	Prizreni - Qendër	31000026033	Mushnikova II	273
DPZ	Prizreni - Qendër	30000015016	Landovica 1	107
DPZ	Dragash	30036007014	bresana III	246
DPZ	Dragash	30036007013	bresana II	163
DPE	Peja - Qendër	50000004017	Fierza I	194
DPE	Klina	52000005002	Mbi Stacion Kulla	258
DPE	Peja - Qendër	50000001001	Instituti I	273
DPE	Istog	54000002018	Vrellë Teuta I (VV3)	135
DPE	Istog	50052006010	Blinda Banje B.Metaj	166
DPE	Peja - Qendër	50000004028	Fejzajt	117
DPE	Peja - Qendër	50000010018	Baliqtë	188

Tabela. 27a Lista e projekteve të planifikuara për vitin 2025.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 36 prej 61
		Versioni	1.0

Distrikti	Subdistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Numri i konsumatorëve
DPE	Peja - Qendër	50000010010	Domi	325
DPE	Peja - Qendër	50000010007	Katundi i ri	154
DPE	Istog	50052006037	Baic Ujrat e zeza	17
DMI	Vushtrri	73000013008	TSB Mbi asfaltt	347
DMI	Vushtrri	73000006005	Vneshta	249
DMI	Vushtrri	73000005026	Shallci-1	40
DMI	Vushtrri	73000005028	TSSh Zhabart	75
DMI	Mitrovicë - Qendër	70000009003	Migjeni	259
DMI	Vushtrri	73000004030	Dolak (lagja Kuqi)	86
DMI	Vushtrri	73000004026	Gurbardh	69
DMI	Vushtrri	73000005006	Novolani-2 (te Shkolla)	108
DGJ	Rahovec	82081007017	Qiflaku I	73
DFE	Lipjan	41000013134	TS Gadime e ulët - Shpella	161
DFE	Ferizaj - Qendër	40042003061	TS Jezerc - Ukzmajl	94
DFE	Ferizaj - Qendër	40042003235	TS Neredime e Eperme (Lagja Jezerceve)	104
DFE	Ferizaj - Qendër	40000014163	TS Bibaj (portallci-Milazim Alija)	253
DFE	Ferizaj - Qendër	40000014150	TS Mirasal (xhamija)	128
DFE	Ferizaj - Qendër	40000014026	TS Rahovic (Zariqët)	110
DFE	Shtime	41046004046	Shtime - Wiliam Woker	251
DFE	Ferizaj - Qendër	40042003174	T.S. Xhamija Balaj	153
DGL	Viti	61067008003	TS-Zijaji	337
DGL	Gjilani - Qendër	60061005062	Te Baja -Bazeni	316
DGL	Viti	61067006024	Drobesh-Sabiti-TS-024	204

Tabela. 27b Lista e projekteve të planifikuara për vitin 2025.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 37 prej 61
		Versioni	1.0

3.1.2 Projektet e bartura në vitin 2025

Distrikti	Subdistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Numri i konsumatorëve
DPZ	Prizreni - Qendër	30000013002	Rruga e Nashecit 2	201
DPZ	Prizreni - Qendër	30000014028	Gjonaj II	157
DPZ	Prizreni - Qendër	30000015032	Lagja ne hyrje Krajku	79
DPZ	Prizreni - Qendër	30033008008	Tusuz (i riu)	213
DPZ	Prizreni - Qendër	30034003014	Dedaj	78
DPZ	Prizreni - Qendër	30034003021	Kushnin i Hasit II	110
DPZ	Prizreni - Qendër	30034003022	Kushnin i Hasit I	99
DPZ	Prizreni - Qendër	30035006005	Vlashne II	149
DPZ	Prizreni - Qendër	30035006009	Muradema	82
DPZ	Prizreni - Qendër	30035008009	Planeja I	63
DPZ	Prizreni - Qendër	30035008010	Planeja II	65
DPZ	Dragash	30036007022	Zaplugje III	82
DPZ	Suharekë	32000003038	Sallagrazhdë Lagja e Dellovceve	39
DPZ	Suharekë	32000019008	Dubrava I	72
DPZ	Suharekë	32000019013	Dubrava III Gashet	40
DPZ	Suharekë	32000023007	Velezha I	82
DPZ	Suharekë	32000023008	Velezha 2	76
DPZ	Suharekë	32000023011	Trepetnice	40
DFE	Ferizaj - Qendër	40041003066	TS Talinovci I Jerlive	185
DFE	Ferizaj - Qendër	40042002190	TS Greme -Xhemshiri	48
DFE	Lipjan	41000003089	Smallush I (TS e vjetra)	93
DFE	Lipjan	41000003090	Smallush II (Hyseni)	97
DFE	Lipjan	41000003242	Smallushë Poturët	89
DFE	Shtime	41046002030	Petrov II - Rexhajt	158
DFE	Shtime	41048001009	Kizharek II (Qelavit)	131
DFE	Shtime	41048001022	Shalë I (Xaja)	64
DFE	Shtime	41048001026	Shalë V (te Kërpuzët)	82
DFE	Lipjan	41048002034	Dobraj e vogël I (te Shashivart)	58
DFE	Lipjan	41048002036	Dobraj e madhe I (Ajvazt)	18
DFE	Lipjan	41048002037	Dobraj e madhe II (Bahtirt)	164

Tabela. 28a Lista e projekteve të bartura për vitin 2025.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 38 prej 61
		Versioni	1.0

Distrikti	Subdistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Numri i konsumatorëve
DFE	Lipjan	41048002038	Dobraj e madhe III (Ajnunët)	92
DFE	Lipjan	41048002040	Dobraj e madhe V (Bublict)	35
DFE	Lipjan	41048002041	Dobraj e madhe VI (xhamija-Lapidari)	58
DGL	Gjilani - Qendër	60060016151	Malisheva e Muhaxherve	89
DGL	Gjilani - Qendër	60060016155	Uglari 2	94
DGL	Gjilani - Qendër	60062002103	Muhaxhert e Shillovës	95
DGL	Viti	61065002140	Qoset	108
DGL	Viti	61065002143	Sadovin e Muhaxherve	118
DGL	Viti	61065004182	Skifteraj - Shkolla	91
DGL	Viti	61065004189	Remnik - Hyrje	69
DGL	Viti	61065005059	TS-059 - Mugillë	83
DGL	Viti	61065012212	Zhiti -Te Emini	47
DGL	Viti	61065012218	Terpeze - Nr 218	141
DGL	Viti	61065014122	Piraj	82
DGL	Viti	61065014156	Ramjan - Shkolla	91
DGL	Gjilani - Qendër	61066006356	Zheger - Te Xhaviti	88
DGL	Viti	61067001103	Stublla - Shkolla	91
DGL	Viti	61067001104	Stubell - Kisha	111
DGL	Viti	61067003034	Feteve	89
DGL	Viti	61067003053	Sadovina e Jerlive	92
DGL	Viti	61067003080	Buzovik	102
DGL	Viti	61067005009	TS-009 - Konstr. te Tregu	153
DGL	Viti	61067010067	Begunce	70
DGL	Kamenicë	62000017169	Toponicë -Muhaxhert	90
DGJ	Rahovec	82000010015	Bestrovci 1	167
DGJ	Rahovec	82000010021	Celina 1	153
DGJ	Rahovec	82000010023	Celina 4	69
DGJ	Rahovec	82000010024	Celina 3	124
DGJ	Rahovec	82081009009	Sapniqi I	110
DGJ	Rahovec	82081009010	Sapniqi II	128
DFE	Lipjan	41048002083	Torin III (Heseti)	117
DPZ	Prizreni - Qendër	30035005003	Hoqe e qytetit IV	134

Tabela. 28b Lista e projekteve të bartura për vitin 2025.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 39 prej 61
		Versioni	1.0

3.1.2 Projektet TU 2025 – Veriu i Kosovës

Distrikti	Subdistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Numri i konsumatorëve
DMI	Mitrovicë - Qendër	70000005002	Vinarce Kulle-1(Lahovit)	63
DMI	Mitrovicë - Qendër	70000005007	Vinarce Zymeri-4	24
DMI	Mitrovicë - Qendër	70000005005	Vinarce i Eperm-3	65
DMI	Mitrovica Veriore	77073001002	Cerajë	-
DMI	Mitrovica Veriore	77073001003	Koshtovë	-
DMI	Mitrovica Veriore	77073001004	Bistricë	-

Tabela. 29 Lista e projekteve të planifikuara për vitin 2025 në Veriun e Kosoves.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 40 prej 61
		Versioni	1.0

4.PROJEKTET NË RRJET TË MENÇUR

Duke qenë se rrjeti shpërndarës është gjithmonë në zhvillim, integrimi i teknologjive të rrjetit të mençur qëndron si një strategji kryesore për rritjen e efikasitetit, besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë. Gjatë vitit 2025 angazhimi i OSSH për të avancuar rrjetin e mençur dhe dixhitalizimin e rrjetit të shpërndarjes nënvizon përkushtimin e kompanisë për të përmbushur nevojat dinamike të konsumatorëve dhe për të siguruar një të ardhme energjie të sigurtë. OSSH viteve të fundit ka qenë mjaft i fokusuar në digjitalizimin e rrjetit elektrik duke zhvilluar sisteme të ndryshme të cilat mundësojnë monitorimin dhe kontrollimin e rrjetit elektrik. Duke përdorur teknologjitë e avancuara të matjes, komunikimit dhe automatizimit, OSSH synon të transformoj sistemin e shpërndarjes në rrjet të digjitalizuar të aftë për monitorim në kohë reale, analizë të të dhënave dhe përgjigje adaptive. Kjo qasje proaktive na lejon të optimizojmë rrjedhën e energjisë, të zbusim defektet në rrjet dhe të integrojmë sisteme të ndryshme të kontrollit. Rritja e aftësive të rrjetit përmes iniciativave të rrjetit të mençur rrit dukshmërinë dhe kontrollin operacional, duke mundësuar të zbulohen dhe adresohen problemet menjëherë, të minimizohet koha e ndërprerjes dhe të përmirësohet besueshmëria e përgjithshme të sistemit. Menaxhimi i sistemit elektroenergetik shpërndarës, mirëmbajtja e tij, kontrollimi dhe monitorimi janë sfidat kryesore të kompanive të cilat operojnë me këtë sistem. Çdo herë në nënstacionet elektrike janë të nevojshme të bëhen matje, mbikëqyrje, kontrolli, operime dhe funksione mbrojtëse me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike. Integrimi i sistemeve të automatizimit, ndryshimet në rrjetin ekzistues elektrik, instalimi i pajisjeve të reja, përdorimi i makinerive janë vetëm disa prej investimeve të parapara në vitet e ardhshme. Fokusi i OSSH në projektet e rrjetit të mençur përputhet ngushtë me qëllimet strategjike të qëndrueshmërisë, inovacionit dhe përqendrimit të konsumatorit. Në tabelën 5 janë paraqitur projektet të cilat do të realizohen gjatë vitit 2025.

Projekti	Sasia
Ndërrimi i mbrojtjeve rele në nënstacione	335
Instalimi i SCADA-ës në SSh	14
Instalimi i FID-ave	9
Instalimi i rimbyllësve automatik	2
Instalimi i rregullatorëve të tensionit	2
Instalimi i mbushësve të veturave elektrike	3
Trafostacioni mobil	1
Totali	

Tabela.30 Projektet në kategorinë Smart Grid.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 41 prej 61
		Versioni	1.0

Më poshtë për secilën nga projektet e përfshira në kategorinë “Smart Grid” do të paraqiten shpjegime më të detajuara.

Ndërrimi i mbrojtjeve rele në nënstacione: Një nga pjesët më të rëndësishme të sistemit shpërndarës është pjesa e sistemit të mbrojtjes sepse është shumë e rëndësishme që sistemi të mbrohet nga defektet e ndryshme që mund të ndodhin. Në sistemin shpërndarës të Kosovës në nivelin e tensionit të mesëm 35 [kV], 20 [kV], 10 [kV] dhe 6 [kV] ekziston një numër i madh i releve mbrojtëse të vendosura në dalje furnizuese, ardhje apo trafofusha me qëllim të mbrojtjes nga lidhjet e shkurta apo mbingarkesat.

Përqindja më e madhe e releve të vendosura në nënstacione kanë tejkaluar jetëgjatësinë e paraparë të tyre të operimit dhe duke e ditur natyrën kritike dhe të ndjeshme të kësaj pajisje atëherë OSSh gjatë vitit 2024 ka ndërruar një numër të konsiderueshëm të releve dhe do të vazhdoj që edhe gjatë vitit 2025 të bëj ndërrimin e releve sipas planit dinamik të njësisë përkatëse. Arsyet se pse OSSh parasheh që të vazhdoj me ndërrimin e releve nëpër nënstacione janë:

- Reletë ekzistuese kanë tejkaluar jetëgjatësinë e paraparë për operim
- Aftësitë teknike të releve janë duke u zvogëluar krahas operimit të tyre
- Reletë ekzistuese të cilat janë propozuar për ndërrim janë rele jo të drejtuara. Relet ekzistuese mund të reagojnë si shkak i lidhjeve të shkurta të cilat mund të ndodhin në daljet tjera.
- Ndërsa reletë të cilat parashihen të blihen do të jenë rele të drejtuara të cilat do të reagojnë apo do të dektojnë defektin apo lidhjet e shkurta vetëm në një drejtim dhe nuk do të reagojnë atëherë kur defekti është në drejtim tjetër.
- Në reletë ekzistuese mundësia e rregullimit të parametrave të mbrojtjes rele për lidhjet e shkurta me tokë në rele është $0.1 \times I_n$, që paraqet një disavantazh shumë të madh për parametrizimin dhe mbrojtjen e mirëfilltë.
- Reletë ekzistuese përfshijnë më pak funksione të mbrojtjes se sa reletë e propozuara për ndërrim.

Gjatë vitit 2025 parashihen që të ndërrohen gjithsej 335 rele mbrojtëse.

Nr.	Viti	Sasia
1	2025	335

Tabela. 31 Ndërrimi i releve në nënstacione.

Përfitimet të cilat do të vijnë pas ndërrimit të mbrojtjeve rele në nënstacionet kryesore janë të shumta, mirëpo vlen të përmenden këto përfitime:

- Do të rritet siguria e sistemit të shpërndarjes

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 42 prej 61
		Versioni	1.0

- Do të zvogëlohet numri i ndërprerjeve apo rënieve të padëshiruara në linjat 35 [kV], 20 [kV], 10 [kV] dhe 6 [kV]
- Do të zvogëlohet numri i ndërprerjeve të padëshiruara të linjave të “shëndetshme”
- Ulja e koston dhe rritja e cilësisë së energjisë
- Mundësia e rregullimit, parametrizimit të mbrojtjeve rele do të jetë më e madhe
- Përdorimi i një numri më të madh të funksioneve të mbrojtjeve rele
- Do të rritet selektiviteti ndërmjet releve në kufirin OSSH dhe OST

Instalimi i sistemit SCADA në stabilimente: Njëra ndër synimet kryesore të OSSH-së është që të rrisë besueshmërinë dhe të zvogëlojë kohën e ndërprerjeve sa i përket furnizimit me energji elektrike. Njëra ndër mënyrat e shumta për të arritur një objektivë të tillë, është instalimi i sistemit SCADA në stabilimente apo nënstatione sekondare. OSSH pas realizimit të monitorimit dhe kontrollit të rrjetit në nivelin e tensionit të mesëm, ka vazhduar me zbatimin e këtij procesi në nivel të tensionit të ulët. Në rrjetin e shpërndarjes ka një numër të madh të stabilimenteve shpërndarëse 10(20)/0.4 [kV] të vendosura në lokacione të ndryshme në të cilat mund të instalohet sistemi SCADA.

Gjatë vitit 2023-2024 OSSH ka përfshirë numrin më të madh të stabilimenteve në sistemin aktual të kontrollit duke arritur që të realizoj me sukses instalimin e sistemit SCADA në stabilimentet kryesore të rrjetit elektrik. Me anë të këtij instalimi OSSH arrinë që t’i monitoroj dhe kontrolloj pikat kyqe të rrjetit elektrik duke pasur qasje të plotë edhe në degëzimet e daljeve 10-20 [kV] në stabilimente.

Sistemi SCADA gjatë vitit 2025 planifikon që të zgjerohet edhe më tutje duke përfshirë edhe 14 stabilimente të tjera të cilat do të identifikohen varësisht parametrave bazë të selektimit të pikave se ku do të instalohet sistemi i tillë.

Pra gjatë vitit 2025 sistemi do të realizohet në 14 stabilimente.

Instalimi i Detektorëve Tregues të Defekteve (FID): Duke qenë se sistemi elektrik i shpërndarjes është një sistem më i ndërlikuar dhe duke e ditur se elementet e këtij sistemi janë të shpërndara nëpër shumë pika qofshin ato të hapura apo të mbyllura mund të themi se sistemi i shpërndarjes është vazhdimisht i ekspozuar ndaj dukurive të defekteve për arsye të ndryshme, si goditja e rufesë, dështimi i pajisjeve, kushtet e këqija atmosferike etj. Të gjitha dukuritë të cilat shkaktojnë prishje apo dështime të rrjetit të shpërndarjes ndikojnë në besueshmërinë e sistemit dhe rezultojnë në riparime ndonjëherë të shtrenjta, humbje të produktivitetit dhe humbje të energjisë për klientët. Meqenëse defekti është i paparashikueshëm, kërkohet një vendndodhje dhe izolim i shpejtë i defektit për të minimizuar ndikimin e këtyre defekteve në sistemet e shpërndarjes. Në shumicën e këtyre prishjeve janë ekipet e rrjetit dhe mirëmbajtjes ato që kanë punën më të madhe për t’i

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 43 prej 61
		Versioni	1.0

eliminuar këto prishje apo defekte dhe për të rikthyer më pas furnizimin me energji elektrike për konsumatorë. Mirëpo tendenca e OSSH-së është që të përdorë pajisje dhe metoda të ndryshme për të lokalizuar defektet e ndryshme që ndodhin në rrjet. Një nga këto pajisje janë edhe detektorët tregues të prishjeve (defekteve). Gjatë vitit 2025 parashihen të instalohen 9 detektorë të tillë në linja 35 [kV].

Instalimi i rimbyllësve automatik: Rimbyllësi automatik është një lloj pajisje komutuese inteligjente e përdorur në automatizimin e rrjetit të shpërndarjes. Mund të zbulojë rrymën e defektit (lidhjeve të shkurta), të shkyç qarkun brenda një kohe të caktuar dhe të kryejë një numër të caktuar rimbylljesh.

Gjatë vitit 2023 dhe 2024 OSSh ka instaluar gjithsej 4 rimbyllës automatik në lartpërçues 10(20) [kV] që përballen me defekte (avari) të shpeshta dhe që shtrihet në zona jo të përshtatshme. Kjo pajisje lejon që furnizimi të rikthehet automatikisht, pas vetëm një ose dy luhatjesh. Rimbyllësi automatik që do të instalohet do t'i kursejë kompanisë kohë dhe shpenzime të konsiderueshme. Ndërsa gjatë vitit 2025 OSSh parasheh që të instaloj edhe 2 rimbyllës automatik të tjerë në zona të cilat konsiderohen problematike. Qëllimi i tërë këtij procesi është që izolohen defektet (avaritë) duke minimizuar impaktin e këtyre defekteve në furnizimin e përgjithshëm me energji elektrike për konsumatorët.

Instalimi i rregullatorëve të tensionit: Tensioni i duhur, disponueshmëria e energjisë sipas kërkesës dhe besueshmëria janë disa nga kërkesat kryesore që duhen plotësuar për të pasur një sistem të mirë shpërndarjeje. Një nga kërkesat më të rëndësishme të një sistemi shpërndarës është që ndryshimet e tensionit duhet të jenë sa më të ulëta që të jetë e mundur. Këto ndryshime të tensionit vijnë si pasojë e ndryshimit të ngarkesës në sistem. Me qëllim të shmangies së rënieve të tensionit dhe me qëllim të sigurimit që ndryshimet e tensionit në терминалет e konsumatorëve të jenë brenda kufijve të lejuar, OSSh planifikon që gjatë vitit 2025 të bëjë instalimin e 2 rregullatorëve të tensionit në daljet 10(20) [kV].

Rregullatorët e tensionit të planifikuar të blihen paraqesin një pajisje që do të sigurojë në dalje tension konstant nën tensione të ndryshme hyrëse dhe rryma të ndryshme të ngarkesës. Rregullatorët e tensionit do të instalohen përpara pikës ku fillon problemi i rënies së tensionit me ngarkesë të madhe dhe do të vendosen në pikat më kritike të sistemit aty ku ndryshimet e tensionit janë më të larta.

Instalimi i mbushësve të veturave elektrike: Si një kompani shpërndarjeje, është thelbësore të përgatitemi në mënyrë proaktive për sfidat dhe mundësitë që sjell tranzicioni energjetik edhe në aspektin e mjedisit. Pikërisht për këtë arsye, OSSH ka integruar disa vetura elektrike dhe do të vazhdojmë t'i integrojmë në mënyrë aktive. OSSH ka filluar dhe do të vazhdoj të punoj për të ndërtuar stacione mbushëse në të gjithë rrjetin tonë. Kjo iniciativë do të promovojë energjinë e pastër, por në të njëjtën kohë tregon dhe gatishmërinë e OSSH për të kontribuar për një mjedis më të gjelbër dhe më të shëndetshëm për ne.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 44 prej 61
		Versioni	1.0

Pra një tjetër investim që do të bëhet gjatë vitit 2025 do të jetë instalimi i karikuesëve (mbushësve) të automjeteve elektrike. Sic shihet automjetet elektrike (EV-të) janë duke u zhvilluar me vull për shkak të disa faktorëve, duke përfshirë uljen e çmimit, si dhe ndërgjegjësimin për klimën dhe mjedisin. Në ditët e sotme, mund të hasim lloje të ndryshme të EV-ve, sipas teknologjisë së motorëve të tyre. Duke pasur parasysh këtë zhvillim, OSSH planifikon që të instaloj 3 mbushës të tjerë të veturave elektrike.

Nënstacioni mobil: Nënstacionet e lëvizshme dhe transformatorët e fuqisë janë zgjidhja më e mirë për përdorim të përkohshëm dhe sa herë që ndryshimet e shpejta dhe të paplanifikuara janë thelbësore. Ato ofrojnë fleksibilitet maksimal dhe përfshijnë një ose disa module kompakte.

Gjatë vitit 2025, OSSH parasheh të blej një nënstacion mobil (të lëvizshëm) i cili do të shërbente për qëllime të ndryshme. Ky nënstacion mobil do të jetë i dobishëm për:

1. Furnizim të konsumatorëve me energji elektrike në raste urgjente
2. Vazhdimësi të shërbimit për punët e planifikuara, mirëmbajtje dhe inspektim.
3. Përdorim të shtimit të kapaciteteve gjatë kohës së mbingarkesave
4. Zëvendësim të nënstacionit në rast të dështimit të pajisjeve
5. Shërbim si burim i energjisë elektrike në zona të izoluara dhe pika shumë kritike

Nënstacioni mobil parashihet të jetë 35/10(20) [kV] dhe elementet e integruara në të përfshijnë:

- 7 kthina (ardhja, daljet, trafo fushat, matja)
- Transformatorin e fuqisë me $S_n=8$ [MVA]
- Rimorkion për transportim

Më konkretisht këto kabina do të përbëhen poashtu edhe nga:

- Pjesa e lidhjes së kablllove,
- Pajisjet e kontrollit dhe mbrojtjes,
- Matja, transformatorët rrymorë dhe të tensionit
- Paneli i furnizimit me energji elektrike AC dhe DC,
- Panelet e komunikimit dhe monitorimit

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 45 prej 61
		Versioni	1.0

Kthinat përbërëse të nënstacionit mobil janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Ana	Kthinat
1	Primare 35 [kV]	1 kthinë ardhëse
2		1 kthinë transformatorike
3	Sekondare 10(20) [kV]	3 kthina dalëse
4		1 kthinë transformatorike
5		1 kthinë matëse

Tabela. 32 Kthinat përbërëse të nënstacionit mobil.

Mbi të gjitha nënstacioni mobil do të jetë në gjendje të transportohet nga një vend në tjetrin me modalitetin e montuar plotësisht. Një çështje tjetër është se jo çdo herë kërkesa për shërbim të përkohshëm apo shërbim emergjent do të jetë në të njëjtin sistem tensioni dhe për këtë qëllim edhe transformatori i lëvizshëm i fuqisë duhet të ketë mundësinë për disa konfigurime të tensionit.

Investimi në blerjen e një sistemi të tillë mobil është paraparë të bëhet gjatë vitit 2025 Përfitimet e një sistemi të tillë janë të shumta si:

- Rikthimi i shpejtë i energjisë pas dështimi të një nënstacioni
- Klientët nuk do të afektohen nga ndërprerjet
- Ulja e indeksit mesatar të kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit (SAIDI)
- Reduktimi i kohës së ndërprerjes/kohëzgjatjes së defektit në shërbimet urgjente
- Fleksibilitet për të planifikuar mirëmbajtjet preventive
- Funkcionim i shpejtë dhe fleksibël i moduleve
- Aplikim efektiv për të plotësuar nevojat e një kërkesë të lartë sezonale
- Zgjidhje e integruar dhe kompakte
- Shfrytëzim maksimal dhe kthim nga investimi

Sistemi Informatik Gjeografik (GIS): Sistemi i Informacionit Gjeografik konsiderohet të jetë njëri prej sistemeve që kërkon kohë për t'u realizuar. GIS është një sistem i vlefshëm për të përmirësuar vendimmarrjen dhe për menaxhim më të mirë të infrastrukturës energjetike. Projekti GIS është planifikuar të zbatohet në tri faza. Në planin e investimeve 2023-2027, OSSh ka propozuar realizimin e Sistemit Informativ Gjeografik (GIS). Kompleksiteti i sistemit të shpërndarjes elektrike të Kosovës dhe nevoja e informacionit të saktë e të përditësuar të aseteve të rrjetit është një synim i arsyeshëm për të patur një sistem të tillë si GIS. Aktualisht OSSh është në fazën e parë ku po përcakton nevojat dhe kërkesat për të patur një sistem të tillë, duke analizuar zgjidhjet nga kompanitë që mund të ofrojnë një sistem të tillë. Për të

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 46 prej 61
		Versioni	1.0

demostruar rëndësinë dhe efikasitetin e këtij sistemi, OSSh sipas rekomandimeve nga Zyra e Rregullatorit gjatë vitit 2024 ka paraqitur pilot projektin e realizuar në daljen 10 [kV] Lumi i Madh në NS 35/10 [kV] Mazigit, me c'rast ka marrë aprovimin për të vazhduar me realizimin e sistemit GIS në tërë territorin e Kosovës. Pilot projekti ka filluar me fazat e para në terren me: Regjistrimin e të gjitha pikave të kyçjes, krijimin e bazës së të dhënave të konsumatorëve, indeksimin e konsumatorëve, hartimin e aseteve, regjistrimin e aseteve, etiketimin dhe numërimin e të gjitha aseteve të rrjetit të shpërndarjes. Duke qenë një projekt mjaft i madh si i tillë sistemi do të vazhdoj të zhvillohet edhe gjatë vitit 2025 e tutje deri në përfundim me c'rast integrimi i të gjitha aseteve të OSSh do të bëhet në një sistem të vetëm.

Të pasurit e një infrastrukture të tillë mundëson vendosjen e sigurt të të dhënave, raportimin e sigurt, caktimin e punëve në terren, miratimin e të dhënave të mbledhura nga tereni, regjistrimin e duhur të aseteve, indeksin e drejtë të të gjithë konsumatorëve, etiketimin dhe numërimin e drejtë të të gjithë inventarit (aseteve) elektrike.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 47 prej 61
		Versioni	1.0

5.PROJEKTET NË NJEHSORË

Ne tabelën e mëposhtme janë dhënë projektet në njehsorë gjatë vitit 2025 dhe sasia e planifikuar për investim për njehsorë të mençur, indirekt, gjysëm indirekt dhe njehsorë elektronik të thjeshtë.

Përshkrimi	Sasia (cope)
Njehsor të mençur	14,000
Njehsor indirekt	50
Njehsor gjysmë indirekt	500
Njehsor elektronik i thjeshtë	23,984
Total	38,534

Tabela. 33 Projektet e aprovuara - Njehsorë.

Ne tabelat e mëposhtme janë dhënë projektet në njehsorë gjatë vitit 2025 dhe sasia e planifikuar për investim për njehsorë të mençur, indirekt, gjysëm indirekt dhe njehsorë elektronik të thjeshtë në Veriun e Kosovës.

Përshkrimi	Njësia	Sasia (cope)
Njehsorë me matje indirekte - prosumator	copë	5
Njehsorë me matje gjysëm indirekte - prosumator	copë	25
Njehsorë me matje direkte GSM/GPRS - prosumator	copë	100
Njehsorë me matje direkte PLC - prosumator	copë	300
		430

Tabela. 27 Projektet për njehsorë – Veriu i Kosovës

Përshkrimi	Njësia	Sasia
Ndërrimi i njehsorëve përmes kontraktorëve	copë	20,000
Ormana	copë	5,000
Kabllo	m	100,000
Fidosa	copë	30,000
Gypa te brinjëzuar Ø32	m	25,000
Përforcues të gypave dhe kabllove	m	10,000
Të tjera për parandalimin e humbjeve	-	-
		190,000

Tabela. 35 Ndërrimi i njehsorëve – Veriu i Kosovës

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 48 prej 61
		Versioni	1.0

6.PROJEKTET NË LOGJISTIKË

Projektet e aprovuara ne “Planin Pesëvjeçar Investues te Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023-2027” per vitin 2025 ne Logjistikë - Makineri janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Nr.
Minivan	12
Automjete të udhëtarëve	6
Automjete me vinç	1
Ekskavatorë	2
Kostoja Totale	21

Tabela. 28 Projektet e aprovuara.

7.PROJEKTET E TEKNOLOGJISE INFORMATIVE(IT)

Projektet e IT-së bëjnë pjesë në projektet me një rëndësi dhe ndjeshmëri të veçantë pasi që i gjithë sistemi i KEDS mund të avancoj apo edhe të rrezikohet për shkak të mos harmonizimit dhe realizimit të investimeve të nevojshme qoftë në infrastrukturë të teknologjisë informative, asaj softuerike por edhe harduerike dhe duke mos e anashkaluar edhe sigurinë kibernetike. Në rastin kur sistemi informativ rrezikohet, atëherë në mënyrë direkte rrezikohen edhe operimet e KEDS.

Në tabelën vijuese janë listuar projektet e Teknologjisë Informative të cilat janë aprovuar nga ZRRE-ja për vitin 2025.

Përshkrimi
ERP
Hardueri
Softueri
Siguria Kibernetike
Data Qendra
Rrjetet e TI
Siguria Fizike
Kostoja Totale

Tabela. 29. Kostoja e aprovuar në PI 2023-2027.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 49 prej 61
		Versioni	1.0

8.PËRFUNDIM

Siç është theksuar në pjesët e mëparshme, është shumë e rëndësishme të zhvillohet vazhdimisht rrjeti i shpërndarjes, veçanërisht në Kosovë, i cili ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Këto investime janë të nevojshme për OSSH-në për të siguruar shërbime të qëndrueshme dhe cilësore. Nevoja për rehabilitimin, zgjerimin, adaptimin dhe aplikimin e standardeve në asetet e sistemit të shpërndarjes është shumë e qartë. Për shkak të kushteve në terren që janë evidente dhe në përputhje me objektivat e rrjetit, nevoja për të orientuar investimet në nivelin e tensionit të ulët si projekte me prioritet të lartë, është e qartë; veçanërisht në fushën më problematike në të cilën ka nevojë për një zgjidhje emergjente dhe që ndikon në një numër më të madh të konsumatorëve. Përmirësimi i kapaciteteve të kufizuara në sistemet e mbingarkuara me tension të lartë dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e rrjetit të tensionit të ulët konsiderohet si kriter bazë meqë plotëson kushtet teknike dhe ekonomike për planifikimin e rrjetit të shpërndarjes dhe siguron furnizim cilësor dhe të sigurtë për pjesën më të madhe të konsumatorëve. Si të tilla, këto projekte përfshihen në Planin Investiv 2024.

Projektet janë të fokusuara në rritjen e besueshmërisë duke zvogëluar ndërprerjet e energjisë elektrike për shkak të ngarkesës (duke përmirësuar SAIDI-n dhe SAIFI-n) në saje të plotësismit të kriterit N-1 dhe duke zvogëluar ngarkesat në daljet e mbingarkuara. Dizajni i ri i projekteve do të sigurojë që kualiteti i përgjithshëm i tensionit të përmirësohet gjithashtu. Përmirësimet në kualitetin e tensionit dhe zvogëlimin e ngarkesave në daljet e mbingarkuara, do të rezultojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike.

Është e rëndësishme të theksohet se disa nga përfitimet e OSSH-së janë të pamatshme, por megjithatë ato ndikojnë në të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike, duke përmirësuar shërbimet e shpërndarjes, rritjen e efikasitetit të fuqisë punëtore dhe cilësinë e furnizimit. Për më tepër, siç u tha më parë, disa nga projektet e parashikuara janë gjithashtu për shkak të kërkesave ligjore, siç janë zëvendësimet e njehsorëve, apo deri tek kërkesat e reja që rrjedhin nga ndryshimet në legjislacion (hapja e tregut). Zbatimi i këtyre projekteve do të mundësojë zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit, do të krijojë kushte të favorshme për konsum të sigurtë, cilësor dhe efikas të energjisë elektrike.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 50 prej 61
		Versioni	1.0

SHTOJCA 1:

PROJEKTET JASHTË PLANIT INVESTIV TË APROVUAR PËR VITIN 2025 SI DHE DETAJET PËRCJELLËSE

Mars, 2025

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 51 prej 61
		Versioni	1.0

Përmbajtje

Hyrje.....	52
1.Projektet e Zëvendësuara	53
1.1.Projektet e Tensionit të Mesëm	53
1.1.1.Efekti i rritjes së kostos së projekteve	54
1.2 Projektet e tensionit të ulët.....	55
1.3 Projektet në SMART GRID	58
2.Projektet Shtesë.....	58
2.1 Projektet e tensionit të mesëm	59
2.1.1 Transformatorët për projektet e vitit 2024 dhe 2025	59
3. Projektet aktuale të aprovuara – rritja e çmimeve.....	61

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 52 prej 61
		Versioni	1.0

Hyrje

Duke marrë parasysh dinamikën e sektorit të energjisë dhe problemet e vazhdueshme me të cilat përballlet Distribucioni, OSSH ka planifikuar edhe disa projekte shtesë jashtë Planit Investiv të aprovuar, ku pas marrjes së aprovimit nga Zyra e Rregullatorit, këto projekte do të implementohen në vitin 2025. Meqë këto projekte po planifikohen për shkak të Sigurisë së Furnizimit disa nga këto projekte po kërkohen të realizohen si projekte shtesë ndërsa disa janë ndërruar me projekte tashmë të aprovuara.

Vitet e fundit si rezultat i zhvillimeve të shpejta, rritja e kërkesave për energji vazhdimisht ka mbingarkuar daljet ekzistuese, kështu që disa dalje kanë arritur në kapacitetet maksimale të linjës dhe patën ndërprerje për shkak të mbingarkesave. Edhe pse për periudhën e viteve 2023-2027, u bë planifikimi i daljeve, gjendja e rrjetit ka ndryshuar dhe si rezultat janë ndryshuar edhe prioritetet e drejtuara nga nevoja për investime në rrjet. Po ashtu ekonomia ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme, me një rritje të ndjeshme në çmimet e të dyjave, materialeve dhe punës prandaj ka edhe ndryshime të kostove me ato që kanë qenë të miratuara.

Prioritizimi i projekteve të investimeve bëhet duke bazuar në kriteret si:

- Ngarkesa Maksimale e Linjës [%]
- Humbjet Teknike [MWh]
- Humbjet Teknike [%]
- Tensioni Min. [p.u]
- Nr.i ndërprerjeve të paplanifikuara
- Numri i konsumatorëve përfitues

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 53 prej 61
		Versioni	1.0

1. Projektet e Zëvendësuara

Gjatë vitit 2023 ZRRE-ja ka aprovuar Planin Investiv për periudhën 2023 – 2027, mirëpo duke marrë për bazë prioritizimin e projekteve ku disa projekte janë ranguar më lartë në raport me disa nga projekte të cilat janë planifikuar për vitin 2025, është shfaqur nevoja për ndryshimin e periudhës së implementimit në raport me planin investiv të aprovuar nga ZRRE.

Gjatë përgatitjes së planeve zhvillimore për periudhë 2025 – 2034 në konsultim me ZRRE-në, janë identifikuar disa nga projekte të cilat janë të domosdoshme që të përfshihen në vitin 2025 pavarësisht se disa prej tyre kanë qenë të aprovuara për vitin 2026 apo 2027. Andaj, në vijim do të pasqyrohen projektet të cilat kanë pësuar ndryshimet në periudhën e implementimit sipas kategorizimit dhe nivelit të tensionit.

1.1 Projektet e Tensionit të Mesëm

Sipas Planit Investiv 5-vjeçar 2023–2027, daljet 10 [kV] Sllovia, Konjuhi dhe Banulla, si projekt i përbashkët me kodin **04/25-07 [20kV]**, dhe daljet në Qendrën e Qytetit në Lipjan, me kodin **04/25-05 [20kV]**, kanë qenë të planifikuara për vitet 2025-2026. Megjithatë, bazuar në tabelën e prioritizimit të kalkuluar me të dhënat e vitit 2023, këto dalje kanë rezultuar me prioritet më të ulët në krahasim me disa dalje të tjera. Daljet 10 [kV] Carraleva & Petrova, si projekt i përbashkët me kodin **04/27-01 [10kV]**, Radavci me kodin **05/27-06 [10kV]**, Vitomirica & Arbreshi me kodin **05/27-08 [10kV]** që janë planifikuar për vitin 2027, Stacioni Hekurudhor & Novolani me kodin **07/26-08 [10kV]** dhe Kraishta me kodin **04/26-01 [20kV]**, që janë planifikuar për vitet 2026-2027, dhe po ashtu Rahovica që është planifikuar për vitin 2028 janë renditur me prioritet shumë më të lartë. Prandaj, është bërë zëvendësimi i këtyre projekteve bazuar në pikët në tabelën e prioritizimit. Më poshtë paraqiten pikët totale për secilën dalje.

Kodi i Daljes	Emri i Daljes	Pikët totale	Viti i Investimit (Aprovuar)	Viti i Investimit (I pëditësuar)
41000004	J11 Konjuhi	7.45	2025-2026	2027
41000012	J22 Banulla	5.60	2025-2026	2027
41000006	J05 Lipjan Qendra I	4.50	2025-2026	2027
41000019	J19 Lipjan Qendra II	3.79	2025-2026	2027
73000004	J07 Stacioni Hekurudhor	9.46	2026-2027	2025-2026
73000005	J06 Novolani	9.46	2026-2027	2025-2026
41000002	J07 Kraishta	9.64	2026	2025-2026
41046004	J04 Carraleva	9.46	2027	2025
50000004	J05 Radavci	9.76	2027	2025-2026
50000010	J02 Vitomirica	9.40	2027	2025
40000014	J14 Rahovica	9.40	2028	2025

Tabela 1. Pikët totale të daljeve që do të zëvendësohen.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 54 prej 61
		Versioni	1.0

ZRRE-ja ka propozuar që daljet Konjuhi dhe Banulla, si dhe daljet në Qendrën e Qytetit në Lipjan, të zhvendosen në vitin 2027, ndërsa dalja Sllovia të mbetet e planifikuar për vitet 2025-2026. Kodet e reja për këto dalje janë: Konjuhi & Banulla **04/27-14 [20kV]**, Daljet në Qendrën e Qytetit në Lipjan **04/27-13 [20kV]** dhe Sllovia **04/25-10 [20kV]**

Carraleva është miratuar pjesërisht me Planin e Investimeve 2023-2027 në vitin 2027, për shkak të prioritetit të lartë ZRRE-ja e ka propozuar që të zhvendoset në vitin 2025. Transferimi i TS-ve nga Carraleva në daljen Petrova është miratuar pjesërisht me Planin e Investimeve 2023-2027, për vitin 2027, ZRRE-ja ka propozuar ndryshimin e vitit të këtij transferimi nga 2027 në 2028, kështu që së bashku me daljen e Albanës është zëvendësuar me daljen e Rahovicës.

Vitomirica & Arbreshi janë miratuar pjesërisht me Planin e Investimeve 2023-2027 për vitin 2027, për shkak të prioritetit, ZRRE ka propozuar që Vitomirica pjesërisht të jetë në vitin 2025. Pjesa e mbetur e Vitomiricës & Arbreshit duhet të realizohet në vitin 2028.

Prandaj, daljet Carraleva, Vitomirica dhe Rahovica do të zhvendosen për vitin 2025, ndërsa Radavci, Stacioni Hekurudhor & Novolani dhe Kraishta do të zhvendosen për vitet 2025-2026. Kodet e reja për këto dalje janë: Carraleva **04/25-13 [10kV]**, Stacioni Hekurudhor&Novolani **07/25-12 [10kV]**, Radavci **07/25-14 [10kV]**, Vitomirica **05/25-15 [10kV]** & **05/28-02 [10kV]**, Kraishta **04/25-11 [10kV]** dhe Rahovica **04/28-01 [20kV]**.

1.1.1 Efekti i rritjes së kostos së projekteve

Nëse i referohemi listës së projekteve të përmendura më lartë, mund të vërehet që disa prej tyre kanë pësuar rritje të kostos së projektit në raport me koston e aprovuar sipas planit investiv për periudhën të cilës i përket. Arsye për rritje të kostos së këtyre projekteve janë kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve për pajisje dhe materialet dhe sigurisht efekti i rritjes së kostos së punëtorëve si pasojë e rritjes së pagës minimale në Kosovë. Të gjitha këto ndryshime në kosto janë jashtë kontrollit të KEDS dhe nuk kanë qenë të parashikueshme për një ndryshim kaq të madh deri më sot.

Gjithashtu, vlen të potencohet se gjatë procesit me rekomandim të ZRRE-së janë bërë ndryshime esenciale në dizajnin e disa projekteve me qëllim të zvogëlimit të kostos së projektit. Ndryshimet të cilat i kemi reflektuar në disa projekte specifike janë si vijon: Shfrytëzimi i trasesë ekzistuese në disa projekte ku ishte e mundur kjo dhe në zonat rurale, në rrugët e ministrisë është planifikuar kanali me shtrirje të lirë, ndërsa në zonat urbane është planifikuar kanal me gypa dhe puseta.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 55 prej 61
		Versioni	1.0

1.2 Projektet e tensionit të ulët

Duke u marrë parasysh zëvendësimet në projektet e tensionit të mesëm, ka rezultuar si afekt në prioritizimin e projekteve të tensionit të ulët dhe kështu që gjatë procesit të përditësimit të planeve zhvillimore në dakordim me ZRrE-në është bërë përditësimi i projekteve të tensionit të ulët duke u bazuar në kriteret e prioritizimit. Kështu që kërkojmë nga Rregullatori aprovimin e projekteve të cilat janë paraqitura në tabelën 3 të cilat i kemi zëvendësuar me projektet e paraqitura në tabelën 4 të hijezuar me ngjyrë të kuqe të cilat janë veçse janë të aprovuara, duke u bazuar në tabelën e prioritizimit të kalkuluar me të dhënat e vitit 2023, disa TS kanë rezultuar me prioritet më të ulët në krahasim me disa të tjerë. Prandaj, është bërë zëvendësimi i disa projekteve bazuar në pikët në tabelën e prioritizimit. Siç është paraqitur dhe në tabelat e mëposhtme benefiti nga projektet e reja është **14,254,101.21[kWh]** ndërsa benefiti nga projektet që kërkohen të largohen nga **Plani Investiv 1 (Një) Vjeçar 2025** dhe të zëvendësohen me projektet e reja është **10,654,488.45 [kWh]**.

Tabela në vijim paraqet projektet të propozuara për tu realizuar përgjatë vitit 2025 dhe tutje.

Distrikti	Nëndistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Nr.i konsumatorëve	Benefit (kWh)
DPR	Prishtina - Veri	13000006085	Ismet Asllani	280	415,162.39
DPR	Prishtina - Jug	19000039147	Hajvalia vorret	333	763,128.47
DPR	Prishtina - Veri	12000015068	Jakov Xoxa 2	453	868,738.93
DPR	Obiliq	18024001038	Lajthishte	182	484,097.90
DPZ	Prizreni - Qendër	31000026025	Iubinja e poshtme II	206	93,563.72
DPZ	Prizreni - Qendër	30000003005	Durmish Asllani IV	598	535,795.74
DPZ	Prizreni - Qendër	30034003011	Romaja I	204	109,896.03
DPZ	Prizreni - Qendër	31000026012	Llokavica	174	32,370.85
DPZ	Prizreni - Qendër	31000026002	Pllanjan I	229	0
DPZ	Dragash	30036007024	zaplugje I	108	112,398.04
DPZ	Prizreni - Qendër	31000026033	Mushnikova II	273	79,843.88
DPZ	Prizreni - Qendër	30000015016	Landovica 1	107	132,612.63
DPZ	Dragash	30036007014	Bresana III	246	59,816.32
DPZ	Dragash	30036007013	Bresana II	163	0
DPE	Peja - Qendër	51000013003	TS 8/2	316	820,664.33
DPE	Peja - Qendër	50000004017	Fierza I	194	316,960.80
DPE	Klina	52000005002	Mbi Stacion Kulla	258	435,429.12
DPE	Peja - Qendër	50000001001	Instituti I	273	746,370.91
DPE	Istog	50052006010	Blinda Banje B.Metaj	166	133,432.92
DPE	Peja - Qendër	50000004028	Fejzajt	117	191,530.29

Tabela 2.Projektet e reja – Benefiti

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 56 prej 61
		Versioni	1.0

Distrikti	Nëndistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Nr.i konsumatorëve	Benefit (kWh)
DPE	Peja - Qendër	50000010007	Katundi i ri	154	280,605.53
DPE	Istog	50052006037	Baic Ujrat e zeza	17	15,580.06
DMI	Mitrovicë - Qendër	70000012001	Ibri	266	553,945.08
DMI	Vushtrri	73000005001	Bukosh-1(Krasaliqët)	143	395,562.69
DMI	Mitrovicë - Qendër	70000012002	Zhabar i Ulet-1 Kulla (Enveri)	193	825,692.59
DMI	Vushtrri	73000006005	Vneshta	249	336,007.54
DMI	Vushtrri	73000005026	Shallci-1	40	237,937.97
DMI	Vushtrri	73000005028	TSSH Zhabart	75	251,436.72
DMI	Mitrovicë - Qendër	70000009003	Migjeni	259	1,122,049.18
DMI	Vushtrri	73000004030	Dolak (lagja Kuqi)	86	194,067.29
DMI	Vushtrri	73000004026	Gurbardh	69	244,298.10
DMI	Vushtrri	73000005006	Novolani-2 (te Shkolla)	108	209,816.52
DGJ	Rahovec	82081007017	QIFLAKU I	73	158,387.72
DFE	Ferizaj - Qendër	40000001233	TS Rr.Varoshit II (Hajrizi)	301	466,563.78
DFE	Ferizaj - Qendër	40000014012	TS Talinovci I Muhaxherëve (Kulla)	408	369,669.60
DFE	Lipjan	41000013134	TS Gadime e ulët - Shpella	161	132,492.62
DFE	Ferizaj - Qendër	40042003061	TS Jezerc - Ukmajl	94	148,182.93
DFE	Ferizaj - Qendër	40042003235	TS Neredime e Eperme (Lagja Jezerceve)	104	166,886.17
DFE	Ferizaj - Qendër	40000014163	TS Bibaj (portallci-Milazim Alija)	253	213,004.31
DFE	Ferizaj - Qendër	40000014150	TS Mirasal (xhamija)	128	20,568.40
DFE	Ferizaj - Qendër	40000014026	TS Rahovic (Zariqët)	110	41,945.36
DFE	Shtime	41046004046	Shtime - Wiliam Woker	251	211,722.00
DFE	Ferizaj - Qendër	40042003174	T.S.Xhamija, Balaj	153	112,183.58
DGL	Viti	61067008003	TS-Zijaji	337	308,481.08
DGL	Gjilani - Qendër	60061005062	Te Baja -Bazeni	316	134,610.87
DGL	Viti	61067006024	Drobesh-Sabiti-TS-024	204	159,474.41
Total					14,254,101.21

Tabela 2a.Projektet e reja – Benefiti

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 57 prej 61
		Versioni	1.0

Tabela në vijim paraqet projektet e vitit 2025 të cilat figurojnë në Planin Ivestiv të aprovuar për periudhën 2023 - 2027.

Distrikti	Nëndistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Nr.i konsumatorëve	Benefit (kWh)
DPR	Obiliq	15019008096	Cakajte-Stanovc	167	456,219.56
DPR	Fushë Kosovë	10012005039	FK Tregu	322	605,118.41
DPR	Prishtina - Jug	19000040002	Hajvali Shkolla	408	424,391.15
DPR	Prishtina - Jug	19000079005	Matiqani 2	395	557,395.88
DPR	Prishtina - Veri	13000003016	Tutinit	385	629,955.10
DPR	Prishtina - Jug	11000008030	Vneshtat 1	219	477,617.74
DPR	Fushë Kosovë	15018019115	Miradi e ulte-te Bullatovcet	126	163,412.66
DPR	Prishtina - Jug	10014002023	Hajvalia I	202	400,858.60
DPR	Fushë Kosovë	10012004029	Bresje MBTS	347	73,922.95
DPR	Prishtina - Jug	10014001062	Mramor te Fetiu	47	205,244.31
DPR	Fushë Kosovë	15018019037	Miradi e ep. Banesat	177	373,331.34
DPR	Obiliq	15019002023	Te Barakat	182	315,962.55
DPR	Obiliq	15019002022	Te Bahollet	187	168,541.22
DPR	Fushë Kosovë	15018019036	Miradi e ep. Xhamia	143	2,072.73
DPZ	Prizreni Qendër	30033004011	Tusus II	529	475,372.15
DPZ	Suharekë	32000002030	Mushtishti Kull-1	293	445,121.31
DPZ	Dragash	30036002004	vranisht I	314	42,506.16
DPE	Istog	50052006017	Banjë Kulla	319	360,004.19
DPE	Deçan	53057003004	Demhaliit -Te Tregu	182	798,555.52
DPE	Klina	52000011003	Gremnik II	143	173,423.32
DPE	Peja - Qendër	50000009024	Nabergjanë Berbatë	120	77,595.71
DPE	Peja - Qendër	51000012006	Ibrahim Haxhitë	234	544,433.78
DMI	Vushtrri	73000002001	Perparimi	445	436818.91
DGJ	Rahovec	82081007013	qifllaku privat(skenderi)	123	22,231.72
DGJ	Gjakova - Qendër	80080008221	TS-52	355	308,814.29
DGJ	Gjakova - Qendër	81000005033	M AHALLA SHEHUT 2	88	0
DGJ	Malishevë	82082001016	CARALLUK II	115	0
DGJ	Malishevë	82082007013	PLLOQICA	61	91,270.56
DGJ	Malishevë	82082002025	LLAPQEVE I	145	2,095.70
DGJ	Gjakova - Qendër	81000005032	MAHALLA SHEHUT 1	178	129,903.12
DFE	Lipjan	41000010153	Ts Lypjan (TS 6), kampi Suma	381	816,237.60
DFE	Lipjan	41000019016	TS Lypjan (TS 1) (Imri Retkoceri)	314	51,236.21
DFE	Lipjan	41048002042	Magure I (te shkolla)	229	256,686.88

Tabela 3.Projektet qe kërkohen të largohen nga Plani Investiv 1 (një) Vjeçar 2025 – Benefiti

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 58 prej 61
		Versioni	1.0

Distrikti	Nëndistrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Nr.i konsumatorëve	Benefit (kWh)
DFE	Kaçanik	40043001001	Voskopoja	240	225,020.24
DFE	Lipjan	41046003043	Godanc - (Xhafa - lagje e pajtimit 1)	135	63,301.88
DGL	Gjilani - Qendër	60060018137	Mireshe-kulla	227	101,648.93
DGL	Gjilani - Qendër	60060018128	Malisheva e Poshtme(busti)	214	153,855.12
DGL	Kamenicë	62000001130	Lajqiqi -1	20	12,159.13
DGL	Gjilani - Qendër	63000010221	Restoran-Kosova	133	89,847.68
DGL	Gjilani - Qendër	60060018133	Verbica e Kmetofcit	109	1,454.79
DGL	Gjilani - Qendër	63000010228	Verbica e ZHegovcit	44	1,341.76
DGL	Kamenicë	62000001115	Shipashnice e Eperme	216	0
DGL	Gjilani - Qendër	60060018330	Ts te Shkolla -Malishev	142	8,735.37
Total					10,654,488.45

Tabela 3a.Projektet qe kërkojnë të largohen nga Plani Investiv 1 (një) Vjeçar 2025 – Benefiti

1.3 Projektet në SMART GRID

Daljet në qendrën e qytetit në Vushtri po mbingarkohen vazhdimisht, dhe në Nënstacionin Vushtrria 2 110/10 [kV] nuk ka hapësirë të lirë për vendosjen e kthinave të reja, ashtu që të krijohen dalje të reja. Në vitin 2027 ishte planifikuar të ndërtohet një NS i ri Vushtrria I 35/10 [kV], i cili do të furnizohet nga Vushtrria 1 110/35 [kV]. Ky Nënstacion do të furnizoj daljet Novolani dhe Stacioni Hekurudhor. Pasi që ZRrE-ja ka propozuar që projekti Stacioni Hekurudhor & Novolani të bartet në vitet 2025-2026 nga viti 2027 atëherë edhe 12 kthinat e planifikuara për NS Vushtrria I 35/10 kV do të zhvendosen në vitin 2025.

2. Projektet Shtesë

Kërkesa për projektet shtesë është bërë për shkak të nevojës urgjente për përmirësimin e rrjetit në zonat më problematike, ku konsumatorët po përballen me mbingarkesë të linjave, kapacitet të pamjaftueshëm, rënie të tensionit dhe ndërprerje të shpeshta të energjisë. Për më tepër, në disa zona rrjeti ekzistues është i vjetëruar dhe përbën rrezik për sigurinë e furnizimit. Për të adresuar këto sfida dhe për të siguruar një furnizim të pandërprerë dhe cilësor, KEDS ka kërkuar nga ZRRE miratimin e projekteve shtesë jashtë Planit Investiv të aprovuar.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 59 prej 61
		Versioni	1.0

2.1 Projektet e tensionit të mesëm

- Projekt shtesë – Jezerci, 04/25-17 [10kV]

Arsyeja pse KEDS e trajton këtë dalje me prioritet të lartë është se dalja ka rezultuar me pikë maksimale (9.76 pikë). Kjo është për shkak se dalja është e mbingarkuar rreth 133%, ka rënie të tensionit në vlerën 0.8 p.u., humbje të larta teknike, dhe numër të lartë të ndërprerjeve të paplanifikuara (219). Në këto rezultate ka ndikuar ngarkesa e madhe maksimale e daljes, numri i madh i degezimeve, numri i madh i TS-ve distributive që furnizohen nga kjo dalje, si dhe gjatësia e madhe e rrjetit ku në fund të linjës, dy degëzime kalojnë në teren malor të papërshtatshëm që ndikon në kohën e gjetjes dhe evitimit të prishjeve si dhe e vështirëson mirëmbajtjen. Në figurën e mëposhtme është paraqitur topologjia e propozuar e daljes Jezerci.




Figura 27. Topologjia e propozuar për daljen 10 [kV] Jezerci.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur kalkulimet teknike për daljen Jezerci.

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Numri i konsumatorëve
Para	Jezerci	4.69	133.64	1,079.55	0.803	219	2,179
Pas	Jezerci	3.95	81.73	784.45	0.876	-	1,852

Tabela 4. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

2.1.1 Transformatorët për projektet e vitit 2024 dhe 2025

Duke pasur parasysh që në “Planin Pesëvjeçar Investiv të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023-2027” nuk kemi kosto të aprovuar për ndërrimin e transformatorëve për daljet që do të konvertohen në 20 [kV], dhe nga ZRRë ne na është kërkuar që transformatorët që duhet të ndërrohen për konvertimin e daljeve në 20 [kV] t’i kërkojmë me anë të planeve investive 1-vjeçare. Ne planifikojmë që gjatë vitit 2025 të bëjmë konvertimin e daljeve ‘Konvertimi i Qendrës së Ferizajt në 20 [kV]’, ‘Kosovapetroli’, ‘Mushtishti’ të cilat

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 60 prej 61
		Versioni	1.0

janë projekte të aprovuar për periudhën 2024-2025. Për të bërë konvertimin në 20 [kV] të këtyre daljeve ne duhet të bëjmë ndërrimin e transformatorëve sipas tabelës së mëposhtme:

Emri i Projektit	Transformatorët									
	50 [kVA]	StepUp 10/20 [kV] 8[MVA]	100 [kVA]	160 [kVA]	250 [kVA]	400 [kVA]	630 [kVA]	1000 [kVA]	1250 [kVA]	1600 [kVA]
Konvertimi i Qendrës së Ferizajt në 20 [kV]			2	2	4	4	18	5		6
Kosovapetroli			2	1	5	3	1	3		
Mushtishti			1	5	13	2	1	1		

Tabela 5. Transformatorët që duhet të ndërrohen – Projektet 2024-2025

Po ashtu për projektet të cilat janë planifikuar për periudhën 2025-2026 duhet të bëhet ndërrimi i transformatorëve sipas tabelës së mëposhtme në mënyrë që pas përfundimit të projekteve të bëhet konvertimi i këtyre daljeve në 20 [kV].

Referuar tabelës së më sipërme numri total i transformatorëve për të gjitha projektet e paraqitura më lartë është **79**.

Emri i Projektit	Transformatorët									
	50 [kVA]	Step Up 10/20 [kV] 8[MVA]	100 [kVA]	160 [kVA]	250 [kVA]	400 [kVA]	630 [kVA]	1000 [kVA]	1250 [kVA]	1600 [kVA]
Dejni	1		5	10	8	3				
Zhupa	4		1	5	3	6	5			
Hasi II	1		3	4	6					
Bresana	1			5	4	2	2			
Gadime	2		1	6	2	1				
Sllovia			7	3	9	6	1	1		
Rahovica			5	5	4	1	2			
Onix & Vrella	1		6	10	13	1	7			

Tabela 6. Transformatorë që duhet të ndërrohen - Projektet 2025-2026

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 61 prej 61
		Versioni	1.0

Referuar tabelës së më sipërme numri total i transformatorëve për të gjitha projektet e paraqitura më lartë është **167**.

Vlen të potencohet se kostoja për transformatorët e projekteve specifike është përfshirë në tabelën nr. 23 tek kapitulli **“Projektet aktuale të aprovuara – me kosto të përditësuara me çmime të reja”** si pjesë e kostos së përgjithshme të projektit.

3.Projektet aktuale të aprovuara – rritja e çmimeve

Meqenëse plani investiv për vitin 2025 është aprovuar përgjatë vitit 2023 dhe si bazë e përlllogaritjes së kostos së projekteve i është referuar çmimeve të vitit paraprak që do të thotë vitit 2022 dhe për para se të shihej efekti i rritjes së çmimeve me të cilët jemi ballafaquar në vitin 2024 dhe pritet të ballafaqohemi edhe përgjatë vitit 2025 dhe në vijim.

Kostoja e projekteve është rritur si pasojë e rritjes së çmimeve për materiale, dhe furnizime duke përfshirë edhe pajisjet dhe stabilimentet si dhe rritja e pagës minimale në Kosovë duke filluar nga muaji Tetor 2024. Dallimet në rritjen e çmimeve vërehen tek linjat ajrore, linjat nëntokësore, ndërtimi i kanalit kabllor, transformatorët. Duke pasur parasysh ndikimin e madh që do të kishte kjo rritje në koston e projekteve në mënyrë për të reflektuar ndikimin e rritjes së kostove dhe për të optimizuar shpenzimet investive, janë marrë parasysh edhe rekomandimet e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE). Në veçanti, janë bërë plotësime dhe ndryshime në dizajnin e disa projekteve duke shfrytëzuar trasenë ekzistuese edhe pse kalon nëpër zona me qasje të kufizuar për ekipet e KEDS-it, si prona private apo zona pa rrugë, duke ulur kështu kostot e ndërtimit dhe duke shmangur shpenzimet shtesë për infrastrukturë të re. Në zonat rurale në rrugë të ministrisë është planifikuar kanal me shtrirje të lirë, ndërsa në qytete, do të implementohet kanal me gypa dhe puseta. Në krahasim me projektet e aprovuara më herët, ku për të gjitha zonat ishte planifikuar kanali kabllor me gypa dhe puseta. Këto ndryshime janë bërë me synimin për të reduktuar kostot pa ndikuar në cilësinë e furnizimit me energji elektrike, dhe pavarësisht sfidave me rritjen e çmimeve sigurojnë realizimin e projekteve me një rritje shumë të lehtë të kostove krahasuar me kostot e aprovuara.